



TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

RAPPORT VJETOR 2024

ZGJEDHJE
PËR
BIZNES
INDIVIDET

BO
TË
MARRËDHËNIE
DHE
STAFIN

Angazhimi me klientët tanë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë dhe më të qëndrueshme!

Ne ofrojmë zgjidhje financiare të shëndosha dhe inovative për individët, profesionistët, klientët dhe bizneset, ndërkohë që përpiqemi të mbajmë marrëdhënie të ngushta me klientët dhe stafin tonë.

VLERAT

- Kënaqësia e Klientit
- Përkushtimi ndaj Integritetit
- Inovacioni & Avancimi Teknologjik
- Efikasiteti Operacional
- Kultura e Pajtueshmërisë
- Ekipi Ynë, Forca Jonë

TONA

TABELA E PËRMBAJTJES

05 PROFILI I KORPORATËS	40 MAD - THESARI (MENAXHIMI I ASETVE DHE DETYRIMEVE)
16 MESAZHE NGA MENAXHMENTI	42 TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT
18 VËSHTRIM MAKROEKONOMIK I VITIT 2024	44 BURIMET NJERËZORE
19 SEKTORI BANKAR I KOSOVËS	46 MENAXHIMI / QEVERISJA E KORPORATËS
23 TEB NË SHIFRA	50 MENAXHIMI I RREZIKUT
26 NJËSITË E BIZNESIT	52 AUDITIMI, PAJTUESHMËRIA, KONTROLLI DHE LIGJORJA
26 Bankimi për Klientë Individual ('Retail')	52 Auditimi i Brendshëm
32 Biznesi i Kartelave dhe POS	52 Pajtueshmëria
34 Bankimi për NVM-të	54 Pajtueshmëria Rregullative
36 Bankimi për Korporata	55 Kontrolli i Brendshëm
38 Qëndrueshmëria dhe Menaxhimi i Aspekteve Mjedisore dhe Sociale (ESG)	55 Ligjorja
	56 RAPORTIMI I AUDITORËVE

PROFILI I KORPORATËS

Vështtrim i Përgjithshëm i Korporatës

Inovacioni, rritja dhe qëndrueshmëria janë gurthemel i identitetit tonë. Gjatë 17 viteve të fundit, TEB SH.A. (TEB) është shfaqur si një forcë udhëheqëse në sektorin bankar të Kosovës, e njohur për përkushtimin e saj për përsosmëri. E udhëhequr nga qëllimi ynë kryesor - "Bankë për një botë në lëvizje" - ne jemi të përkushtuar për të fuqizuar klientët tanë, familjet dhe komunitetet e tyre për të arritur sukses përmes një numri gjithëpërfshirës të produkteve dhe shërbimeve.

Aftësia jonë për të mbështetur klientët dhe punonjësit buron nga lidhja jonë me Grupin TEB, e krijuar përmes një partneriteti në mes të dy institucioneve të fuqishme financiare: BNP Paribas, një autoritet i fuqishëm global dhe, Türk Ekonomi Bankası, një bankë prestigjioze në Turqi. Si anëtar i këtij konsorciumi të respektuar ndërkombëtar, TEB shfrytëzon përvojën e gjerë të Grupit, stabilitetin financiar dhe shtrirjen globale për të ofruar vlerë të pakrahasueshme.

TEB në shifra



Përparësitë Konkurruese të TEB



*Bazuar në Ungarijen e BQK-së

VIZIONI, MISSIONI DHE STRATEGJIA

Vizioni

Vizioni i TEB SH.A. është që të bëhet banka e zgjedhur në Kosovë për klientët individual dhe të biznesit.

Misioni

Për të krijuar dhe rritur vazhdimisht vlerën e jashtëzakonshme për klientët, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë tonë.

Strategjia

•**Rritja e qëndrueshme:** Zgjerimi i pranisë në treg dhe bazën e klientëve në të gjitha segmentet duke zbatuar strategji që nxisin rritjen e qëndrueshme dhe forcojnë marrëdhëniet me klientët.

•**Digjitalizimi:** Përdorimi i teknologjisë për të rritur efikasitetin operacional dhe për të ofruar një përvojë të jashtëzakonshme për klientët dhe punonjësit përmes zgjidhjeve inovative digjitale.

•**Stabiliteti financiar:** Sigurimi i stabilitetit financiar nëpërmjet menaxhimit efektiv të rrezikut, ndarjes së kredive me cilësi të lartë dhe respektimit të rreptë të proceseve të pajtueshmërisë rregullative.

Vlerat themelore

Në TEB SH.A., ne jemi të përkushtuar të respektojmë parimet themelore që udhëheqin përpjekjet tona të korporatës drejt rezultateve pozitive dhe të qëndrueshme në të gjitha dimensionet.

Kënaqësia e Klientit

Theksi ynë në ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë duke e vendosur klientin në qendër të operacioneve tona. Produktet dhe shërbimet e përshtatura janë krijuar me përpikëri për të adresuar kërkesat unike të sipërmarrësve, bizneseve, punonjësve, studentëve dhe të moshuarve. Synimi ynë është të kultivojmë një mjedis ku klientët ndihen të vlerësuar dhe të qetë kur menaxhojnë çështjet e tyre financiare.

Përkushtimi ndaj Integritetit

Integriteti është gurthemeli i operacioneve tona, duke mbështetur çdo ndërvëprim dhe vendim. Ne i përmbahemi me rigorozitet standardeve më të larta etike, duke siguruar që besimi dhe transparenca përcaktojnë marrëdhëniet tona me klientët, aksionarët dhe punonjësit. Ky përkushtim ndaj integritetit jo vetëm që forcon reputacionin tonë, por gjithashtu siguron rritje të qëndrueshme dhe elasticitet në një peizazh financiar konkurrues dhe gjithnjë në zhvillim.

Inovacioni dhe Avancimi Teknologjik

Duke përqafuar epokën digjitale, ne jemi të përkushtuar ndaj përmirësimit të vazhdueshëm, duke siguruar që produktet dhe shërbimet tona të mbeten në ballë të avancimeve teknologjike dhe në përputhje me pritjet në zhvillim të klientëve.

Efikasiteti Operacional

Ne jemi të përkushtuar për të krijuar procese operacionale dhe produkte që i japin prioritet lehtësisë për përdoruesit, qasshmërisë dhe shtimit të vlerës. Qëllimi ynë është të sigurojmë që shërbimet tona të jenë lehtësisht të qasshme dhe të dizajnuara në mënyrë intuitive për të përmirësuar përvojën e përdoruesit. Për më tepër, ne përpiqemi të mbajmë struktura të drejta çmimesh që pasqyrojnë me saktësi vlerën e ofruar nga ofertat tona.

Kultura e Pajtueshmërisë

Të rrënjosur në traditën e respektuar të pajtueshmërisë së BNP Paribas, ne kemi krijuar një kornizë solide dhe fleksibile të pajtueshmërisë që përputhet me standardet ndërkombëtare dhe rregulloret e brendshme.

Ekipi Ynë, Forca Jonë

Ne e kuptojmë se mirëqenia e ekipit tonë është thelbësore për suksesin tonë. Duke promovuar një kulturë respekti, përfshirjeje dhe fuqizimi, ne synojmë të mbështesim zhvillimin e secilit anëtar. Nëpërmjet bashkëpunimit, mirënjohjes dhe fokusit në ekuilibrin punë-jetë, ne përpiqemi të kultivojmë një mjedis ku të gjithë ndihen të vlerësuar dhe të inkurajuar për të arritur potencialin e tyre të plotë.

STRUKTURA

AKSIONARE

Kapitali aksionar i TEB Bankës është 24,000,000 € bazuar në 2,400,000 aksione të emetuara, secila me vlerë nominale prej 10 €.

Numri i aksioneve i referohet aksioneve të zakonshme

*Banka kontrollohet nga TEB Holding A.S. që një është kompani e themeluar në Turqi ("Kompania amë"), e cila zotëron 100% të aksioneve të Bankës. Aksionarët e TEB Holding A.S. janë BNP Paribas dhe Grupi Çolakoğlu, ku secili prej tyre ka në pronësi 50% të aksioneve. BNP Paribas është pala e fundit kontrolluese e kompanisë amë dhe e Bankës.

**Aksionar që nga
31 dhjetor 2024**

TEB HOLDING A.S.*

**Pronësia e aksioneve
e paguar në kapital (K)**

24,000,000

Aksione

100%

Përgjegjësia Sociale dhe Shpërblimet në 2024

Roli i Departamentit të Reklamimit dhe Komunikimit të Korporatës është kritik në formësimin e identitetit të brendit të Bankës, reputacionit dhe angazhimit të bankës ndaj klientit. Gjatë vitit të kaluar, Departamenti është fokusuar në forcimin e pozicionimit të brendit, rritjen e pranisë digjitale dhe përforcimin e besimit të palëve të interesit përmes strategjive të komunikimit të synuar.

Shpërblimet

- Tatimpagues i Vitit 2024 nga Oda Ekonomike e Kosovës
- Punonjës i Vitit 2024 nga Oda Ekonomike e Kosovës
- Mirënjohje për Përgjegjësinë Sociale Korporative (PSK) nga Oda Ekonomike e Kosovës për sponsorizimin e ekipit Kombëtar të futbollit të Kosovës
- Fushatat (kampanjat) më të mira për kredit kartelë nga VISA

Sponsorizimet:

- Sponsor i Përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Ekipit të Kombëtares,
- Sponsor i Përgjithshëm i Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Ekipit të Kombëtares,
- Sponsor i Përgjithshëm i Komitetit Paralimpik të Kosovës dhe paraqitjes së tyre të parë në Lojërat Paralimpike në Paris 2024,
- Sponsor i alpinistes të klasit botëror Uta Ibrahim (një nga 8 femrat e botës që është ngjitur në 14 majat më të larta),
- Sponsor kryesor i Festivalit Ndërkombëtar të Operës Ramë Lahaj,
- Sponsor kryesor i Turneut të Tenisit Dielli TEB Open 2025,
- Sponsor kryesor i javës së Frankofonisë në Kosovë,
- Sponsor kryesor i Festivalit Ndërkombëtar të Xhazit në Prishtinë,
- Sponsor kryesor i Forumit të Biznesit Turqi-Kosovë në Stamboll, Turqi
- Sponsor i Konferencës "E ardhmja e Biznesit",
- Festivali i Muzikës për Fëmijë Vihuela,
- Darka Gala Vjetore Bamirëse e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë

Donacionet:

- Shoqata Humanitare e Prindërve me Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore,
- Festivali i Fëmijëve Lyra,
- Ambasada Franceze - Dita e Bastilës,
- Shoqata e Kardiologjisë së Kosovës,
- Muzika na bashkon - Dita Ndërkombëtare e Muzikës,
- Shoqata e të Verbërve,
- FIDAF (Federata Ndërkombëtare e Festivaleve të Vallëzimit) - Kosova është anëtare e FIDAF,
- Klubi Alpin Prishtina - Mont Everest,
- Sports4All - Prishtina Street Fest,
- Klubi Gërmia - Atletikë për Fëmijë,
- Festivali Ndërkombëtar i Artit të Pikturave - Festivali Ndërkombëtar i Artit,
- Klubi i Zhytjes 038 - Pastrimi brenda ujit të liqenit të Batllavës,
- Ambasada e Turqisë - Dita Kombëtare.



Sponsor i Përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Ekipit të Kombëtares



Sponsor i përgjithshëm i Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Ekipit të Kombëtares



Sponsor kryesor i Turneut të Tenisit Dielli TEB Open 2025



Sponsor i Përgjithshëm i
**Komitetit Paralimpik të
Kosovës dhe paraqitjes së tyre
të parë në Lojërat Paralimpike
në Paris 2024**

**Klubi i Zhytjes 038
Pastrimi brenda ujit të
liqenit të Batllavës**



Sponsor i alpinistes **të klasit
botëror Uta Ibrahimi**

**Një nga 8 femrat e botës
që është ngjitur në
14 majat më të larta**






Sponsor kryesor i Festivalit Ndërkombëtar të Operës Ramë Lahaj



Sponsor i Festivalit të Muzikës për Fëmijë Vihuela



Festivali i fëmijëve Lyra

Sponsor kryesor i Festivalit Ndërkombëtar të Xhazit në Prishtinë



ATMOSPHERES...

Mitrovica, Capitale kosovare de la Francophonie

Construisons la transformation ensemble

2024

Building transformation together

Du 21 au 27 mars




TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Sponsor kryesor i javës së Frankofonisë në Kosovë





SHËNOJMË NJË TJETËR VIT TË ARRITJEVE TË RËNDËSISHME DHE RRITJES SË QËNDRUESHME

Të nderuar Aksionarë

Është krenari e madhe të prezantoj Raportin Vjetor të vitit 2024 të TEB SH.A., duke shënuar një vit tjetër të arritjeve të konsiderueshme dhe të rritjes së qëndrueshme. Si anëtare e Grupit BNP Paribas, i njohur si lider në shërbimet bankare dhe financiare në Evropë, dhe të Türk Ekonomi Bankası (TEB), një nga bankat më të njohura dhe të rrënjosura thellë në Turqi, ne mbështetemi në një kombinim të fuqishëm të ekspertizës globale dhe njohurive rajonale. Ky partneritet strategjik rrit aftësinë tonë për t'u ofruar klientëve tanë zgjidhje financiare inovative, të sigurta dhe me vlerë të lartë në të gjithë Kosovën. Viti 2024, në veçanti, ishte i suksesshëm për sektorin bankar të Kosovës. Themelet ekonomike mbetën të qëndrueshme dhe BPV-ja e Kosovës u rrit me 4.4%, e nxitur nga konsumi i fortë vendor, investimet publike dhe një fluks i vazhdueshëm i remitancave. Për më tepër, BPV-ja për krye banori u rrit në 6,431 euro, duke reflektuar përmirësime në prosperitetin individual dhe përfshirjen ekonomike. Duke u bazuar në këtë moment, TEB SH.A. arriti rezultate të jashtëzakonshme: portfolio jonë e bruto kredive u zgjerua me 18%, depozitat e klientëve u rritën me 13% dhe arritëm një kthim mbi kapitalin prej 21.1%.

Këto rezultate demonstrojnë forcën e modelit tonë të biznesit dhe angazhimin tonë për të nxitur rritje të qëndrueshme ekonomike në Kosovë.

Duke shikuar tutje drejt vitit 2025, ne ruajmë një perspektivë shumë optimiste dhe të motivuar. Të mbështetur nga aksionarët tanë dhe të pasuruar nga aleanca sinërgjike e BNP Paribas dhe TEB Bank, ne jemi të përkushtuar për të përsheptuar transformimin tonë digjital, për të rritur angazhimin e klientëve dhe për të zgjeruar qasjen financiare në të gjithë vendin. Në të njëjtën kohë, ne do të mbetemi plotësisht në përputhje me standardet rregullative dhe të përkushtuar ndaj niveleve më të larta të qeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut, të cilat janë thelbësore për vizionin tonë afatgjatë.

Ne jemi gjithashtu të përkushtuar për të investuar në mirëqenien e shoqërisë sonë. Në vitin 2024, ne shërbyem me krenari si sponsor i përgjithshëm i ekipeve kombëtare të futbollit dhe basketbollit të Kosovës dhe mbështetëm iniciativë të shumta në muzikë, kulturë dhe qëndrueshmëri mjedisore. Këto përpjekje pasqyrojnë bindjen tonë se bankat duhet të kontribuojnë në mënyrë aktive në pasurimin e strukturës sociale dhe kulturore të komunitetit tonë.

Në emër të Bordit të Drejtorëve, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time më të thellë për punonjësit, klientët dhe aksionarët tanë për përkushtimin, besimin dhe partneritetin e tyre të vazhdueshëm. Së bashku, ne po formësojmë të ardhmen e shërbimeve bankare në Kosovë përmes forcës, inovacionit dhe një vizioni të unifikuar për sukses të qëndrueshëm.

Ayşe Aşardağ



VITI I KALUAR KA QENË NJË SHEMBULL TJETËR I VEÇANTISË SË KOSOVËS

Viti i kaluar ka qenë një shembull tjetër i veçantisë së Kosovës. Duke sfiduar pritjet në rritje ekonomike, siguri dhe zhvillim teknologjik, Kosova vazhdon të shkëlqejë. Arritëm të kalonim një regjistrim të ri të popullsisë i cili na dha shumë më tepër të dhëna demografike, morëm një vlerësim shumë të favorshëm krediti nga Fitch, dyfishuam pagën tonë minimale dhe thjesht kaluam në zgjedhje paqësore të cilat janë shembull në të gjithë rajonin e Ballkanit. Si Bankë jemi krenarë që u shërbejmë klientëve tanë dhe jemi pjesë e kësaj shoqërie të mrekullueshme.

Kjo rritje dhe zhvillim ka intensifikuar disi konkurrencën në sektorin financiar. Banka jonë, së bashku me bankat e tjera të këtij sektori, kanë zhvilluar me shpejtësi produkte dhe shërbime të reja që kanë përfituar shumë klientët në përgjithësi. Procesi i digjitalizimit po ndodh më shpejt se sa ishte parashikuar dhe përdorimi i shërbimeve bankare është bërë më i lehtë duke mos i vizituar degët fizikisht.

Ne kemi parë se liberalizimi i vizave nuk është materializuar në një efekt të konsiderueshëm migrimi që do të thotë se, pavarësisht nga perceptimi i jashtëm, Kosova është një vend i mrekullueshëm për të jetuar dhe plot potencial. Kosova si shtet është ende një vend mjaft tërheqës për investime të huaja. Vitin e kaluar, ritmi i ndërmarrjeve të huaja që krijojnë qendrat e tyre të prodhimit apo shërbimit në Kosovë është rritur. Ne presim që situata të përmirësohet në mënyrë eksponenciale nëse ka stabilitet politik në rajon.

Banka jonë vazhdon të punojë duke pasur klientin në qendër dhe duke përqendruar përpjekjet e saj për digjitalizim në ofrimin e kanaleve që përdoren më tepër nga klientët tanë. Aplikacioni ynë për telefon mobil është përditësuar ndjeshëm vitin e kaluar, duke ofruar më shumë funksionalitet se kurrë më parë dhe ne e dimë se ka vend për ta zhvilluar edhe më shumë aplikacionin tonë. Me ndryshimet e ardhshme rregullatore dhe planin e Kosovës për t'iu bashkuar SE-PA-s, ne presim që bankat të jenë shumë më dinamike në Kosovë. Siç do të tregojë ky raport vjetor, Banka jonë ka bërë një punë të jashtëzakonshme vitin e kaluar.

Kostoja e rrezikut të Bankës sonë mbetet historikisht e ulët dhe të ardhurat nga interesi dhe jo interesi janë rritur duke mbetur në përputhje me kërkesat lokale dhe të Grupit. Ne po punojmë vazhdimisht për të rritur kënaqësinë e klientëve dhe punonjësve duke marrë vendime të bazuara në të dhënat. Unë jam mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme nga Bordi ynë i Drejtorëve dhe Aksionarët tanë, të cilët janë pjesë integrale në realizimin e vizionit tonë përmes të gjitha sfidave që ka përjetuar Kosova në të kaluarën. Banka jonë është në pozicionin më të mirë për të mbështetur klientët tanë për çdo plan që ata mund të kenë në të ardhmen.

Orçun Özdemir

VËSHTRIM MAKROEKONOMIK I VITIT 2024

Në vitin 2024, ekonomia globale vazhdoi të zhvillohet në një peizazh kompleks të karakterizuar nga ngadalësimi i rritjes, inflacioni i ngritur dhe tensionet e rritura gjeopolitike. Sipas IMF Outlook (Perspektivës së FMN-së), rritja globale e PBB-së është parashikuar prej 3.3% në 2025, nga 3.2% në 2024. Në euro zonë, pritet të ketë rritje, por me një ritëm më gradual me 1% në 2025, nga 0.8% në 2024.

Rritja e PBB-së: PBB-ja në Kosovë arriti në 10.3 miliardë euro në vitin 2024, me një normë reale të rritjes së PBB-së prej 4.4%, mbi shifrën e vitit 2023 prej 4.1%. Kjo rritje është nxitur kryesisht nga konsumi privat, investimet publike dhe remitancat, të cilat mbeten një kontribuues i rëndësishëm në ekonomi. Kjo normë e rritjes e thekson aftësinë e vendit për të mbajtur një rrugë të qëndrueshme të rritjes pavarësisht sfidave të jashtme. PBB për kokë banori është rritur me 940 euro për shkak të rënies së popullsisë nga 1.8 milionë në 1.6 milionë banorë në vitin 2024. Megjithatë, parashikimi i FMN-së për vitin 2025 vazhdon të marrë parasysh popullsinë prej 1.8 milionë banorë.

Papunësia: Shkalla e papunësisë vazhdoi trendin e saj rënës, duke arritur në 11% në fund të vitit 2023 dhe 10.8 në fund të tre-mujorit të dytë të vitit 2024. Ky përmirësim është nxitur nga krijimi i vendeve të punës në sektorin privat, në veçanti në ndërtim, shitjet me pakicë ('Retail') dhe shërbimet.

Mjedisi Makroekonomik në Kosovë

Ekonomia e Kosovës ka demonstruar qëndrueshmëri dhe rritje konsistente në vitin 2024, e mbështetur nga kërkesa e fuqishme e brendshme, rritja e remitancave dhe një sektor financiar stabil. Treguesit makroekonomik të vendit reflektojnë një trajektore pozitive pavarësisht nga mjedisi sfidues global dhe rajonal.

Inflacioni (Indeksi i Çmimit të Konsumit): Inflacioni, i cili arriti kulmin në vitin 2022 për shkak të ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit global dhe goditjeve të çmimeve të energjisë, është zbutur në 1.6% në vitin 2024, nga 4.9% në vitin 2023. Kjo rënie i atribuohet stabilizimit të çmimeve globale të mallrave dhe politikave më të shtrënguara monetare në Eurozonë, partnerit kryesor tregtar të Kosovës.

Remitancat: Remitancat, një komponent kritik i ekonomisë së Kosovës, pritet të arrijnë në 1.3 miliardë euro në vitin 2024, që përbëjnë afërsisht 13.2% të PBB-së. Ky fluks i qëndrueshëm i remitancave vazhdon të mbështesë konsumin familjar dhe stabilitetin ekonomik, duke theksuar rëndësinë e kontributit të diasporës në ekonominë kombëtare. Remitanca për vitin 2024 nuk është shpallur ende, duke pasur parasysh kohën e përgatitjes së këtij raporti vjetor.

Treguesit Makroekonomik të Kosovës

Treguesit	2022	2023	2024	2025 (P)	2026 (P)
PBB (€ milion)	8,896	9,680	10,305	10,949	11,611
Rritja e PBB-së (%)	4.3	4.1	4.4	4.0	4.0
PBB për kokë banori (euro)	5,049	5,491	6,431	6,205	6,576
Inflacioni (%)	11.6	4.9	1.6	2.0	2.0
Papunësia (%)	12.6	10.9	10.8	-	-
Remitencat (€ milion)	1,219	1,336	1,357	1,456	1,544
Remitencat (% PBB)	13.7	13.8	13.2	13.3	13.3

Burimi: FMN World Economic Outlook, 2024; Banka Qendrore e Kosovës (BQK); Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Perspektiva për vitin 2025

Bazuar në treguesit makroekonomik të Kosovës, sektori bankar ka përfituar nga rritja e qëndrueshme e PBB-së, zbutja e inflacionit dhe rënia e papunësisë në vitin 2024. PBB-ja e parashikuar prej 4% për vitet në vijim, e nxitur nga konsumi privat, investimet publike dhe remitancat, tregon një mjedis të qëndrueshëm ekonomik që do të mbështesë kreditimin dhe aktivitetin financiar. Në përgjithësi, sektori bankar pritet të përjetojë rritje të qëndrueshme, me mundësi në huadhënie dhe zgjidhje bankare digjitale për të përmbushur nevojat në zhvillim të klientëve dhe të biznesit në vitin 2025.

SEKTORI BANKAR I KOSOVËS

Sistemi financiar i Kosovës përbëhet nga Bankat Komerciale, Institucionet Mikrofinanciare, Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet Pensionale. Në vitin 2024, aktivitetet kredituese të Bankave Komerciale dhe të Institucioneve Mikrofinanciare shfaqën rritje të ndjeshme, në veçanti, portfolio e kredisë së Bankave Komerciale është zgjeruar me 18 %, duke arritur 5,813 milionë euro në total, ndërsa kreditë e dhëna nga Institucionet Mikrofinanciare u rritën me 21%, në vlerën 552 milionë euro. Bankat Komerciale vazhdojnë të forcojnë pozicionin e tyre dominues në sistemin financiar, duke llogaritur 91% të totalit të nevojave financiare, duke përfshiruar në këtë mënyrë rolin e tyre kryesor në këtë sektor.

Struktura e Bankave Komerciale			
	2023	2024	Ndryshimet
Numri i Bankave	12	11	-1
nga të cilat në pronësi të huaj	9	8	-1
Numri i zyrave	215	227	12
Pronësia e huaj	84.30%	83.60%	-0.007
Numri i punonjësve	4,022	4,143	121

Burimi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Performanca bankare

•**Totali i Aseteve:** Në vitin 2024, sektori bankar i Kosovës vazhdoi të zgjerohet, me gjithsej asetet që u rritën me 13% për të arritur në 8.556 miliardë euro. Kjo rritje është nxitur nga rritja e aktivitetit kreditues dhe rritja e qëndrueshme e depozitave, duke reflektuar përmirësimin e besimit në sistemin financiar.

•**Kreditë (Bruto):** Kredia bruto u rrit me 18% në 5.813 miliardë euro, duke treguar kërkesë të fortë për kredi nga individët dhe bizneset. Rritja e kreditimit u mbështet nga përpjekjet e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për të rritur qasjen në kredi, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).


•**Depozitat:** Totali i depozitave u rrit me 13% në 6,923 miliardë euro, duke reflektuar një trend në rritje të përfshirjes financiare. Rritja e depozitave u mbështet edhe nga flukset hyrëse të remitancave, të cilat arritën një nivel rekord prej 1,357 miliardë euro në vitin 2024, duke llogaritur 13,2% të PBB-së.

Kjo trajektore e rritjes pritet të vazhdojë në vitin 2025, me totalin e aseteve të parashikuara për të tejkaluar 9 miliardë euro, të nxitura nga zgjerimi i mëtejshëm i kredisë dhe mobilizimi i rritur të depozitave.

Rritja e kredisë ka të ngjarë të mbetet e fuqishme për shkak të kërkesës së qëndrueshme për kredi të biznesit dhe nevojave për financim të klientëve, të mbështetur nga kushtet e favorshme ekonomike dhe përmirësimi i infrastrukturës financiare.

Rritja e depozitave parashikohet të përputhet me trendet më të gjera ekonomike, ku bankat fokusohen në rritjen e depozitave të klientëve për të ruajtur likuiditetin.

Treguesit e rritjes (milion €)




Stabiliteti Financiar

Kthimi në kapital (KNK) KNK qëndroi në 19.9% në 2024, duke theksuar përfitimin e fuqishëm të sektorit dhe shfrytëzimin efikas të kapitalit.

Kreditë Jo-Performuese (KJP): Raporti i kredive jo-performuese (KJP) të sektorit mbeti në nivele të ulëta prej 1.9%, të provizionuara plotësisht, duke treguar një menaxhim të shëndoshë të rrezikut të kredisë. Zbatimi i standardeve të likuiditetit dhe mjaftueshmërisë së kapitalit të Basel III forcoi më tej qëndrueshmërinë e sektorit.


RMK (Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit): Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit prej 16.2% mbetet i fuqishëm, duke reflektuar standardet e Basel III.

Treguesit e Stabilitetit Financiar



Profitabiliteti

Fitimi neto i sektorit u rrit me 17% në 182 milionë euro, duke reflektuar të ardhura më të larta nga interesi dhe të ardhura të bazuara në tarifa. Kjo performancë u nxit nga rritja e fuqishme e kredisë, përmirësimi i efikasitetit operacional dhe një raport i ulët KIP prej 1.9%, i cili plotësisht është i provizionuar



Në vitin 2025, profitabiliteti pritet të ketë një vull pozitiv, i nxitur nga rritja e vazhdueshme e kredisë, përmirësimet e efikasitetit dhe diversifikimi i të ardhurave të bazuara në tarifa. Megjithatë, rritja e investimeve digjitale dhe presionet konkurruese mund të kërkojnë menaxhim strategjik të kostos.

Digjitalizimi dhe Zhvillimet e Qëndrueshmërisë

Sektori bankar i Kosovës bëri hapa të rëndësishëm në digjitalizim dhe qëndrueshmëri në vitin 2024, duke u përafruar me trendet globale dhe kërkesat rregullative.

Transformimi Digjital: Sektori bankar i Kosovës përshpejtoi transformimin e tij digjital në vitin 2024, duke u përafruar me Agjendën Digjitale të Qeverisë së Kosovës 2030 (DAK 2030).

- Numri i llogarive të e-banking tejkaloi 1 milion, duke sinjalizuar një zhvendosje drejt pagesave digjitale.

- Prezantimi i aplikacionit për anëtarësim në SEPA (Zonë e Vetme e Pagesës në Euro) shënoi një moment historik kyç në rritjen e integritetit financiar dhe efikasitetit.

- BQK-ja gjithashtu ka miratuar standardin e kodit QR për pagesat, duke rritur efikasitetin dhe sigurinë e transaksioneve për klientë individual ('Retail').

- Sektori pati një rritje prej 32% në transaksionet me POS, duke reflektuar rritjen e preferencës për pagesat pa para të gatshme.

Qëndrueshmëria dhe Menaxhimi i Aspekteve, Mjedisore dhe Sociale (ESG): Përpjekjet për qëndrueshmëri në sistemin bankar kanë marrë vull me miratimin e Agjendës së Gjellbër nga Qeveria e Kosovës në vitin 2021.

•Strategjia dhe Plani Kombëtar i Zhvillimit 2030 (SKZH 2030), e financuar nga Bashkimi Evropian dhe e nënshkruar nga Qeveria në vitin 2023, paraqet një ngjarje të rëndësishme për përpjekjet për qëndrueshmëri në Kosovë. Strategjia është e strukturuar rreth katër shtyllave: (i) zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, (ii) zhvillimi i barabartë njerëzor, (iii) siguria dhe sundimi i ligjit dhe (iv) qeverisja e mirë. Veçanërisht, fokusi në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik inkurajon sektorin bankar të financojë projekte të qëndrueshme dhe të mbështesë iniciativat e transformimit digjital.

•Sektori bankar përqafoi parimet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG), me miratimin e BQK-së të Udhërrëfyesit Strategjik për Rreziqet lidhur me Klimën dhe Mjedisin në Sektorin Financiar (2025-2027). Ky udhërrëfyes synon të integrojë aspektet e ESG-së në kornizën e menaxhimit të rrezikut të bankave dhe të promovojë financim të qëndrueshëm.

•BQK-ja gjithashtu iu bashkua Rrjetit të Qëndrueshëm të Bankave dhe Financave (SBFN), duke ofruar qasje në trajnime të avancuara dhe mjete rregullative për menaxhimin e rreziqeve klimatike.

•Në vitin 2024, Shoqata e Bankave të Kosovës (ShBK) dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për të përmirësuar shërbimet financiare digjitale dhe ekosistemet fintech në Kosovë, të mbështetur nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO). Kjo nismë synon të harmonizojë sistemet financiare të Kosovës me standardet evropiane, duke promovuar përfshirjen financiare dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Në vitin 2025, digjitalizimi dhe qëndrueshmëria do të mbeten fushat kryesore të fokusit për sektorin. Zbatimi i projektit TIPS Clone, në bashkëpunim me Bankën e Italisë, pritet të revolucionarizojë pagesat e menjëhershme në Kosovë, duke rritur më tej efikasitetin e transaksioneve ndërkufitare. Për më tepër, bankat do të vazhdojnë të zhvillojnë produkte dhe shërbime në përputhje me ESG, duke kontribuar në tranzicionin e gjellbër të vendit dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Parashikimi për Vitin 2025

Duke shikuar tutje në vitin 2025, ne parashikojmë që sektori bankar të mbajë trajektoren e tij të rritjes nën stabilitetin e vazhdueshëm makroekonomik, në përputhje me parashikimet e FMN-së për rritje prej 4% të PBB-së. Sektori pritet të ruajë vullin e tij pozitiv; megjithatë, reformat strukturore dhe menaxhimi i zgjeruar i rrezikut do të jenë thelbësore për të adresuar sfidat e vazhdueshme dhe për të siguruar rritje të qëndrueshme. Zhvillimet rregullative dhe iniciativat strategjike do të luajnë një rol vendimtar në formësimin e së ardhmes së peizazhit bankar të Kosovës, duke siguruar qëndrueshmëri dhe konkurrencë në një mjedis financiar në zhvillim.

TEB NË SHIFRA

	2024	2023	Rritje/(Ulje)	Përqindje
Treguesit e bilancit të gjendjes (000 EUR)				
Asetet në total	1,001,117	858,736	142,381	16.6%
Kreditë në total (Bruto)	730,036	608,520	121,516	20.0%
Depozitat	846,175	722,942	123,234	17.0%
Kapitali i aksionarëve	138,547	115,442	23,105	20.0%
Kredi bruto / Asetet në total	72.9%	70.9%	2.0pp	-
KJP / Kreditë në total	0.92%	1.13%	(0.2pp)	-
KJP Raporti i mbulimit	71.2%	72.0%	(0.8pp)	-
Treguesit e pasqyrës së të ardhurave				
Të ardhurat neto nga interesi	48,540	41,320	7,220	17.5%
Të ardhura neto pa interes	10,271	9,101	1,170	12.9%
Të ardhurat neto bankare	58,811	50,417	8,394	16.6%
Fitimi neto për vitin	27,030	22,900	4,130	18.0%
Raporti kosto/të ardhura	48.2%	48.2%	0.0pp	-
Efkti i nofullës	0.05%	0.70%	(0.65pp)	-
Raportet e përfitimit				
Kthimi në kapital ("KNK")	24.4%	25.1%	(0.7pp)	-
Kthimi në asete ("KNA")	2.7%	2.7%	0.0pp	-
Interesi neto/Asetet mesatare që krijojnë interes	6.3%	6.1%	0.2pp	-
Raportet e aftësisë paguese dhe likuiditetit				
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit ("RMK")	15.1%	14.7%	0.4pp	-
Asetet likuide / Detyrimet afatshkurtra	24.8%	26.9%	(2.1pp)	-
Asetet e peshuara ndaj rrezikut ("APR")	754,567	639,281	115,286	18.0%
Tregues të tjerë				
Degët	34	30	4	13.3%
Punonjësit	611	604	7	1.2%

TREGUESIT KRYESORË FINANCIARË

POZICIONI FINANCIAR I BANKËS

Më 31 dhjetor 2024, asetet e Bankës arritën në 1,001 milionë euro, duke shënuar një moment të rëndësishëm, pasi tejkaluan 1 miliard euro në asetet totale. Kjo reflekton një rritje prej 142 milionë euro nga 858.7 milionë euro në fund të vitit 2023. Ashtu si edhe në vitin e kaluar, kreditë bruto mbetën klasa mbizotëruese e aseteve, duke llogaritur 72.9% të totalit të aseteve. Portfolio bruto e kredisë u rrit me 20% (122 milionë euro), duke arritur në 730 milionë euro nga 608.5 milionë euro në fund të vitit 2023.

Cilësia e kredisë u përmirësua ndjeshëm, me raportin e KJP-ve që ra në 0.92% në 2024 nga 1.13% në 2023, duke shënuar raportin më të ulët të KJP-ve në mesin e bankave kryesore në Kosovë. Banka mbajti një raport të fuqishëm të mbulimit me KJP (Faza 3) prej 71.1% në 2024, pak më e ulët se 72% në 2023. Raporti i kostos së rrezikut në 0.15% në 2024, ishte pothuajse në të njëjtin nivel si në 2023 (0.11%). Këto raporte pasqyrojnë praktika të kujdesshme të menaxhimit të rrezikut dhe qeverisje të fortë të korporatës.

Nga ana e detyrimeve, depozitat e klientëve u rritën në 846.2 milionë euro më 31 dhjetor 2024, një rritje prej 17.0% nga 722.9 milionë euro në fund të vitit 2023. Në fund të vitit 2024, raporti kredi ndaj depozitave të Bankës ishte afërsisht 85%. Për më tepër, me kapitalin total që arrin në 138.5 milionë euro, Banka ruan një bazë të qëndrueshme financimi për të mbështetur rritjen e vazhdueshme të kredisë.

PERFORMANCA FINANCIARE E BANKËS

Të ardhurat neto nga interesi u rritën me 17.5%, në 48.5 milionë euro në 2024, krahasuar me 41.3 milionë euro në 2023. Kjo rritje u ndikua nga një rritje prej 18.5% në totalin e të ardhurave nga interesi, duke arritur në 7.8 milionë euro.

Gjithashtu, të ardhurat neto pa interes arritën në 10.3 milionë euro më 31 dhjetor 2024, duke reflektuar një rritje prej 12.8% nga 9.1 milionë euro në fund të vitit 2023.

Kjo rritje është nxitur kryesisht nga të ardhurat më të larta nga tarifat dhe komisionet, kryesisht nga llogaritë, kartelat dhe transferet e parave. Ndërkohë që shpenzimet e tarifave dhe komisioneve u rritën gjithashtu, rritja e të ardhurave nga tarifat dhe komisionet tejkaloi rritjen e shpenzimeve. Si rrjedhojë, të ardhurat neto bankare u rritën në 58.8 milionë euro në 2024 nga 50.4 milionë euro në 2023.

Në vitin 2024, Banka menaxhoi efektivisht raportin e saj kosto-të ardhura, duke e mbajtur atë në 48.2%, duke theksuar përkushtimin tonë të vazhdueshëm për efikasitetin operacional. Për më tepër, Banka arriti efektin nofull pozitiv prej 0.05% në 2024, pasi që të dyja, të ardhurat neto bankare dhe shpenzimet operative u rritën me 16.6%.

Fitimi neto u rrit me 18.0% në 27.03 milionë euro në 2024, nga 22.9 milionë euro në 2023, duke shënuar fitimin neto më të lartë në historinë e Bankës. Banka regjistroi një kthim në kapital prej 24.4%, në përputhje me nivelet e vitit 2023, dhe një kthim në asete prej 2.7%, gjithashtu në përputhje me vitin e kaluar. Raporti neto i interesit ndaj asetet fitimprurëse mesatare nga interesi u përmirësua nga 6.1% në 2023 në 6.3% në 2024, duke treguar efikasitet të rritur në gjenerimin e të ardhurave nga interesi nga fitimi i aktiveve.

Raportet e Aftësisë Paguese dhe Likuiditetit

Sa i përket raporteve të aftësisë paguese dhe likuiditetit, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave mbeti i qëndrueshëm në 15.1% për fundin e vitit 2024, duke tejkaluar kërkesën minimale të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) prej 12%. Në ndërkohë, asetet e peshuara ndaj rrezikut u rritën me 18.0% (EUR 115.3 million), kryesisht për shkak të rritjes së portfolios së kredisë.

Për më tepër, raporti i mbulimit të likuiditetit (LCR) qëndroi në 273.08%, dhe raporti neto i financimit të qëndrueshëm (NSFR) ishte 140.86%, të dyja dukshëm mbi kërkesën rregullative prej 100%. Këto raporte tregojnë se MAD-Thesari menaxhoi në mënyrë efektive transformimin e bilancit të gjendjes.

Tregues të Tjerë

Në vitin 2024, Banka hapi 4 degë të reja, duke e çuar numrin total në 34 (nga 30 në 2023). Ndërkohë, numri i punonjësve me kohë të plotë është rritur lehtë në 611 krahasuar me 604 në fund të 2023.

Bankimi për Klientë Individual ('Retail')

2024, VITI I THYERJES SË REKORDIT TË BANKIMIT PËR KLIENTË INDIVIDUAL

Viti 2024 ka qenë një vit transformues për Divizionin e Bankimit për Klientë Individual, pasi kemi vendosur standarde të reja në përvojën e klientit, performancën financiare dhe transformimin digjital. Angazhimi ynë për të ofruar zgjidhje bankare të pakrahasueshme, jo vetëm që ka përforcuar pozicionin tonë në sektor, por gjithashtu na ka pozicionuar për një sukses edhe më të madh në vitin 2025.

PERSPEKTIVA FINANCIARE E VITIT 2024

Peizazhi financiar i vitit 2024 u formësua nga mjedisi i qëndrueshëm ekonomik, inflacioni i moderuar dhe një rritje e qëndrueshme e besimit të klientit, si dhe një mjedis tregu dinamik dhe konkurrues, me ndryshimin e preferencave të klientëve, zhvillimet rregullative dhe inovacionet teknologjike.

Këto kushte lejuan industrinë bankare të lulëzonte, veçanërisht në bankimin për klientë individual, ku menaxhimi financiar personal dhe adoptimi i bankimit digjital arritën lartësi të reja. Banka jonë ka kapitalizuar këto tendenca duke prezantuar fushata (kampanja) dhe oferta të reja kreditimi, duke optimizuar portfoliot e depozitave dhe duke shfrytëzuar analitikën e të dhënave për të ofruar zgjidhje të personalizuar për klientët tanë.

PËRVOJA E KLIENTIT: NJË PRIORITET KYÇ

Duke kuptuar se kënaqësia e klientit është shtylla kryesore e suksesit tonë, ne bëmë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e përvojës së klientit tonë. Nga thjeshtimi i procesit të pranimit tek reduktimi i kohës së përgjigjes në ofrimin e shërbimit, iniciativat tona u krijuan për të krijuar një udhëtim bankar pa probleme për klientët tanë. Angazhimi i shtuar i klientëve përmes bankimit digjital luajti një rol vendimtar në forcimin e marrëdhënieve tona me klientët individualë.

INVESTIMET NË TEKNOLOGJI

Strategjia jonë e transformimit digjital në 2024 u përqendrua në inovacionin, efikasitetin dhe sigurinë. Investimet e mëdha na lejuan të përsosim ofertat e produkteve tona dhe të parashikojmë nevojat e klientëve me saktësi më të madhe. Zgjerimi i aftësive tona të mobile banking (bankimit përmes celularit) siguroi një përvojë të kryerjes së shërbimeve pa vështirësi, ndërsa masat e fuqishme të sigurisë kibernetike përforcuan besimin e klientëve në ekosistemin tonë digjital.

Pavarësisht këtyre sfidave, ne arritëm rezultate të fuqishme dhe realizuam çështje të rëndësishme. Në vijim janë paraqitur disa nga momentet kryesore të vitit:

PRODUKTET INOVATORE DHE FUSHATAT E VITIT 2024

Për të përforcuar më tej fuqinë tonë në bankimin për klientë individual, ne lansuam disa produkte dhe fushata (kampanja) inovatore të përshtatura për segmente të ndryshme të klientëve. Disa nga pikat kryesore përfshijnë:

- Zgjidhjet e Kredisë Smart: Një produkt dinamik huadhënës që rregullon normat e interesit bazuar në sjelljen e kredisë së klientit, duke ofruar lehtësi dhe qasje më të mirë.
- Iniciativa të përshtatura: Një fushatë (kampanjë) e fokusuar për marrësit e pagave, duke u mundësuar atyre të kenë qasje pa probleme në kredi, kredit kartela, mbitërheqje dhe zgjidhje bankare digjitale.
- Produktet e kredisë digjitale: Zgjerimi i portfolios të ofertave të kredisë digjitale për të ofruar qasje pa probleme në financim përmes platformave tona të bankimit online dhe mobile banking (bankimi përmes celularit)
- Zgjerimi i partneriteteve për fushata inovative: Forcimi i bashkëpunimeve me partnerët e ndërlidhur me hipotekat dhe të auto industrisë për të nxitur blerjen, financimin dhe angazhimin e klientëve.
- Fokusi në depozitat pa interes: Inkurajimi i rritjes së depozitave me kosto të ulët duke ofruar zgjidhje të përshtatura që përputhen me qëllimet financiare të klientëve dhe nevojat për likuiditet.

PERFORMANCA FINANCIARE

2024 PËR PRODUKTET KRYESORE

ZHVILLIMI I BAZËS SË KLIENTIT

Objektivat e përvetësimit të klientëve patën progres në përputhje me supozimet strategjike. Në vitin 2024, baza e klientëve të Bankimit për Klientë Individual ('Retail') është rritur me 13.20% me 37,000 klientë të ri. Sa i përket klientëve aktivë, 76% e bazës sonë të klientëve janë klientë aktivë të cilët përdorin vazhdimisht produktet e bankës sonë.

Ndër të tjera, TEB Bankimi për Klientë Individual ('Retail') ka arritur të zhvillojë bazën e pranuesve të pagave, me çka ka arritur të rrisë bazën ekzistuese me 12.5%.

KREDITË INDIVIDUALE




Kreditë për Klientë Individual ('Retail') mbetën një shtytës kryesor i rritjes në vitin 2024, me një zgjerim të konsiderueshëm në kreditë personale dhe kreditë hipotekore, duke tejkaluar objektivat dhe pritshmëritë tona, me një zhvillim vjetor prej 17.2%. Si rezultat, TEB-i në kreditë për klientë individual arriti një rritje prej 44.5 milionë me pjesë të tregut prej 14.7%. Portfolio totale e shumës së kredisë është 303 milionë.

Ky sukses u nxit nga disa faktorë, si produktet inovative, çmimet konkurruese, shërbimi i shkëlqyer ndaj klientit dhe fushatat efektive të marketingut. Rritja e kredive pasqyron angazhimin tonë për të ofruar zgjidhje financiare të qasshme dhe të përballueshme për klientët tanë.


DEPOZITAT INDIVIDUALE

Në vitin 2024, pavarësisht kushteve agresive të tregut dhe konkurrencës në rritje, Divizioni për Klientë Individual ('Retail') rriti me sukses bazën e depozitave duke u fokusuar në depozitat pa interes. Kjo arritje pasqyron besimin që kemi ndërtuar ndër vite me klientët tanë, të cilët vazhdojnë ta shohin bankën tonë si partnerin e preferuar për nevojat e tyre financiare.

Baza totale e depozitave u rrit me 9.2% nga viti në vit, me një rritje mbresëlënëse prej 51 mil të depozitave pa interes. Kjo u realizua përmes një kombinimi të përkushtimit të synuar të klientit, menaxhimit superior të marrëdhënieve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar që përforcuan besimin e klientit në ruajtjen e fondeve të tyre tek ne.



Në vitin 2024, Bankimi për Klientë Individual ('Retail') ka pasur rritje në fusha të ndryshme të performancës financiare, e nxitur nga iniciativat strategjike dhe angazhimi për të mbajtur një model biznesi stabil dhe të qëndrueshëm.



BANKIMI PËRMES CELULARIT - TEB MOBILE

Bankimi për Klientë Individual ('Retail') është revolucionarizuar vitet e fundit, me teknologjinë celulare që luan një rol kryesor në drejtimin e këtij transformimi. Ndërsa tendencat në mobile banking (bankimi përmes celularit) vazhdojnë të rriten, banka jonë është pozicionuar me krenari në ballë të këtij zhvillimi.

Gjatë vitit të kaluar, ne kemi qenë dëshmitarë të një rritje të konsiderueshme të numrit të klientëve që përdorin TEB Mobile, duke arritur në 175,700 klientë, një rritje prej 21.2 për vitin 2024. Kjo arritje nënvizon angazhimin tonë të palëkundur për të ofruar zgjidhje të përshtatshme, të sigurta dhe inovative për klientët tanë, si dhe shkathhtësinë tonë për t'u përshtatur me nevojat dhe preferencat në zhvillim të tregut për të siguruar që klientët tanë të gëzojnë përvojën më të mirë të mundshme bankare.

CILËSIA E PORTFOLIOSË KREDIVE - KREDITË JO-PERFORMUESE

Në vitin 2024, Bankimi për Klientë Individual ('Retail') ka demonstruar performancë të jashtëzakonshme në menaxhimin e cilësisë së portfolios të kredive individuale. Nëpërmjet vlerësimit të fuqishëm të rrezikut të kredisë dhe monitorimit të vazhdueshëm, ne mbajmë një raport të shëndetshëm të KJP-ve nën 1.43%, duke tejkaluar mesataret e tregut. Iniciativat kryesore përfshinin sisteme të përmirësuara të paralajmërimit të hershëm, ristrukturim proaktiv të borxhit, rritje të përpjekjeve për rikuperim dhe angazhim të përkushtuar nga rrjeti ynë i degëve. Krahas suksesit në rritjen e kredisë, ne ruajtëm cilësinë e portfolios tonë të kredive individuale me raportin e kredive jo-performuese në 0.64%. Si rezultat, portfolio jonë mbeti e qëndrueshme, duke mbështetur rritjen e qëndrueshme dhe duke përforcuar besimin e klientëve në produktet tona të kreditimit.

Vizioni Strategjik për Transformimin Digjital

Në vitin 2024, Divizioni i Bankës për Klientë Individual ('Retail') ishte i vendosur në avancimin e shitjeve tona digjitale përmes kanaleve digjitale të fuqishme. Fokusi ynë strategjik ishte në digjitalizimin e avancuar të produkteve dhe shërbimeve tona, duke siguruar që klientët të kishin qasje në teknologjinë më të avancuar dhe ofertat inovative. Pas Programit tonë Digjital gjithëpërfshirës, ne kemi ofruar shërbimet e mëposhtme nëpërmjet platformave tona digjitale:

- Zgjidhje gjithëpërfshirëse të huadhënies digjitale: Kredi të lehtësuara, kredit kartela dhe produkte të tjera financiare përmes ndërfaqeve digjitale me një qasje gjithëpërfshirëse dhe efikase.
- NjKT (Njih Klientin Tuaj) digjitale e zgjeruar: Identifikimi dhe verifikimi digjital i zgjeruar i klientit direkt nga aplikacioni i mobile banking (bankimit përmes celularit) për të siguruar që keni informacionin më të përditësuar.
- Zgjerimi i gamës së shërbimeve digjitale: Pasurimi i ekosistemit tonë digjital duke prezantuar shërbime të reja, duke mundësuar një bankë të pavarur pa vizita në degë.
- Projektet e efikasitetit dhe automatizimi: Procese manuale plotësisht të automatizuara për të rritur efikasitetin dhe reduktuar gabimet përgjatë operacioneve.

Përmirësimi i Pranisë dhe Qasshmërisë Digjitale

Për të forcuar praninë tonë digjitale, ne u përkushtuam për t'i bërë kanalet tona digjitale lehtësisht të zbulueshme dhe të qasshme për klientët. Kjo nismë strategjike synonte të nxiste rritjen e trafikut në platformat tona digjitale. Për më tepër, ne shfrytëzuam kanale të ndryshme marketingu për të promovuar grupin tonë të produkteve dhe për të udhëhequr klientët drejt ofertave tona digjitale.

Promovimi i Përdorimit Aktiv të TEB Mobile

Në vitin 2024, një nga objektivat tona kryesore ishte pajisja e klientëve tanë aktivë, veçanërisht atyre që përdorin produkte kreditore, depozita dhe klientët me paga, me produktin TEB Mobile. Kjo përputhej me qëllimin tonë për të rritur përdorimin e TEB Mobile në mesin e bazës tonë të klientëve.

Përkushtimi për Shërbim të Jashtëzakonshëm ndaj Klientit

Përkushtimi ynë është shtrirë përtej teknologjisë. Ne e kuptuam rëndësinë kritike të shërbimit të jashtëzakonshëm ndaj klientit. Prandaj, ne krijuam porta të dedikuara për të trajtuar të gjitha aplikacionet digjitale nëpër kanalet tona të ndryshme, duke përfshirë TEB Mobile, Uebfaqe, E-Banking dhe Email. Ky investim siguroi që klientët të merrnin ndihmë të shpejtë dhe efikase.

Programi Inovativ i Digjitalizimit

Duke shikuar tutje, banka jonë mbetet e përkushtuar ndaj Programit tonë të Digjitalizimit. Vizioni ynë është të krijojmë një ekosistem inovativ të shërbimeve bankare të ofruara në mënyrë digjitale. Duke kaluar lehtësisht nga një model bankar konvencional në atë hibrid (bankë konvencionale dhe digjitale), ne synojmë të rrisim përvojën bankare për klientët tanë përmes zgjidhjeve me shumë kanale.

Shënim: Programi i Digjitalizimit, i iniciuar në vitin 2023, vazhdoi të jetë një forcë shtytëse në rrugëtimin tonë drejt një peizazhi bankar të avancuar teknologjikisht.

PËRQAFUAR TË ARDHMEN: VIZIONI YNË PËR VITIN 2025

Pasi ne shikojmë tutje në vitin 2025, vizioni ynë strategjik mbetet i ancoruar në tri shtylla themelore:

PËRVOJË E PAKRAHASUESHME E KLIENTIT

Angazhimi ynë i palëkundur për të ofruar një përvojë të pakrahasueshme të klientit do të vazhdojë të drejtojë përpjekjet tona. Në vitin 2025, ne do të fokusohemi në përmirësimin e personalizimit përmes njohurive të bazuara në të dhëna, prezantimit të pranimi digjital të klientëve dhe sigurimit të ndërveprimeve të pandërprera në të gjitha kanalet. Gjithashtu, ne do të investojmë në zgjerimin e ekipeve tona të shërbimit ndaj klientit, përmirësimin e programeve të trajnimit dhe shfrytëzimin e teknologjisë për të ofruar zgjidhje më të shpejta dhe më efikase për pyetjet dhe shqetësimet. Qëllimi ynë është ta bëjmë bankën më të thjeshtë, më intuitive dhe të rrënjësuar thellë për nevojat e përditshme financiare të klientëve tanë.

ZGJERIMI I HORIZONTEVE PËR RITJE

Rritja e qëndrueshme mbetet në qendër të strategjisë sonë. Ne do të fokusohemi në zgjerimin e bazës tonë të klientëve duke forcuar angazhimin e klientë-marrësve të pagave, duke thelluar depërtimin e produkteve dhe duke rritur pjesën tonë të tregut në kredi dhe depozita individuale. Për më tepër, ne do të nxisim adoptimin e produkteve të kredisë digjitale, do të rrisim bilancet e depozitave pa interes dhe do të krijojmë partneritete të reja për të përshpejtuar përfshirjen financiare.

EKSELENCË PËRMES EFIKASITETIT

Maksimizimi i efikasitetit operacional do të jetë çelësi për ruajtjen e përfitimit në një mjedis bankar dinamik. Fokusi ynë do të jetë në transformimin digjital, automatizimin dhe optimizimin e strukturave të kostos. Nëpërmjet platformave digjitale të vetë-shërbimit, ne synojmë të rrisim produktivitetin duke ruajtur standardet superiore të shërbimit.

RRUGA TUTJE: 2025 VIT TRANSFORMUES

Ndërsa hyjmë në vitin 2025, ne jemi të përgatitur për një vit transformimi, inovacioni dhe rritjeje. Fokusi ynë do të jetë në ofrimin e përvojave të pakrahasueshme të klientëve, zgjerimin e pranisë sonë në treg dhe nxitjen e përsosmërisë operacionale. Me një qasje të përqendruar te klienti, ne do të forcojmë ekosistemin tonë digjital, do të prezantojmë zgjidhje financiare më të fundit dhe do të përforcojmë fuqinë tonë në sektorin bankar.

Duke pasur parasysh ndryshimet dhe kërcënimet e ndryshme në sigurinë kibernetike, si dhe çështjet natyrore apo gjeopolitike në botën e sotme, Banka ka vënë një fokus të fuqishëm në vazhdimësinë e biznesit dhe menaxhimin e krizave. Ajo po përqendrohet në strategjitë për të siguruar stabilitet operacional dhe komunikim efektiv gjatë ndërprerjeve, qoftë nëse ato vijnë nga faktorë të brendshëm ose të jashtëm ose nga një krizë në shkallë të plotë. Për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe efektive ndaj vazhdimësisë dhe menaxhimit të krizave, është krijuar një funksion i veçantë për vazhdimësinë e biznesit dhe menaxhimin e krizave. Funksioni i raporton ZKR-së dhe Komitetit të Vazhdimësisë së Biznesit.

Rezultatet e Rrezikut Operacional dhe Vazhdimësisë së Biznesit raportohen çdo muaj në Komitetin e Rrezikut dhe çdo tre-mujor në Bordin e Drejtorëve.

Në vitin 2024 nuk ka pasur humbje të mëdha operationale, përveç shumave minimale të deficiteve në para të gatshme.

AUDITIMI, PAJTUESHMËRIA, KONTROLLI DHE LIGJORJA

Auditimi i Brendshëm

Funksioni i Auditimit të Brendshëm është një nga komponentët kyç në strukturën e qeverisjes së Bankës, si linja e tretë e mbrojtjes. Ai është i pavarur dhe si i tillë i raporton drejtpërdrejtë Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Auditimit.

Auditimi i Brendshëm, si pjesë e Inspektimit të Përgjithshëm, është një funksion sigurie, misioni i të cilit është të sigurojë, si rezultat i ekzaminimit objektiv të provave, një garanci të pavarur dhe objektive se qeverisja, menaxhimi i rrezikut dhe kontrolli i Bankës janë përcaktuar dhe menaxhuar në mënyrë të duhur dhe efektive. Është përgjegjësi e Departamentit të Auditimit të Brendshëm të ofrojë vlerësim për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e proceseve të TEB SH.A. Kosova, në mënyrë që të kontrollojë aktivitetet e Bankës dhe të menaxhojë rreziqet që lindin nga proceset. Departamenti i Auditimit të Brendshëm është i përfshirë në detyra të përbashkëta me IG HUB Turkey dhe Central IG, duke pasuruar më tej njohuritë dhe përvojën e Departamentit.

Aktivitetet e auditimit kryhen nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm sipas planit të auditimit, i cili përgatitet të paktën në baza vjetore duke përdorur një metodologji të bazuar në rrezik, e cila përfshin pasqyrën e një plani shumëvjeçar të auditimit të kaluar dhe të ardhshëm për t'u siguruar që të gjitha njësitë e Bankës janë audituar brenda ciklit të auditimit. Plan vjetor vlerësohet nga Komiteti i Auditimit dhe miratohet nga Bordi i Drejtorëve.

Puna e Departamentit të Auditimit të Brendshëm kryhet në përputhje me ligjet, rregulloret, praktikat e auditimit në grup në fuqi, dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të zhvilluara nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm, i cili është organi drejtues për profesionin e auditimit të brendshëm në mbarë botën.

Pajtueshmëria

Funksioni ynë i Pajtueshmërisë siguron që TEB SH.A. mbetet një bankë e besueshme, jo vetëm duke respektuar ligjet dhe rregulloret, por edhe duke respektuar perceptimin e ligjeve dhe rregulloreve.

Ne jemi të përkushtuar ndaj bankmit të përgjegjshëm dhe të vepruarit me integritet dhe përgjegjësi në çdo gjë që bëjmë. Është e vetëkuptueshme që pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet dhe udhëzimet më të larta ndërkombëtare është pjesë e identitetit tonë dhe përbën themelin për mënyrën se si funksionon Pajtueshmëria jonë. Funksioni ynë i Pajtueshmërisë operon për të qenë në përputhje me rregulloret dhe standardet, ligjet e Kosovës si dhe ligjet ndërkombëtare, duke përfshirë praktikën dhe standardet më të mira të njohura globalisht për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe korrupsionit. Ne analizojmë klientët tanë dhe transaksionet e tyre për të parandaluar që emri ynë, emrat e vetë klientëve dhe produktet dhe shërbimet tona të keqpërdoren për qëllime të tilla. Kjo mund të shihet në madhësinë e Funksionit të Pajtueshmërisë sa i përket numrit të punonjësve, si dhe në zbatimin e mjeteve të avancuara që lidhen me PPP/LFT dhe Sanksionet Financiare Ndërkombëtare.

Ndryshimet rregullative, gjeopolitike dhe shoqërore e vendosin Pajtueshmërinë në udhëkryq të strategjisë dhe veprimit të përditshëm të bankës dhe klientëve të saj. Në një mjedis ku zhvillimet rregullative, gjeopolitike dhe sociale janë të shumta dhe komplekse, Funksioni ynë i Pajtueshmërisë siguron respektimin e të gjitha rregulloreve bankare, financiare dhe rregulloreve të tjera, duke ndihmuar kështu në garantimin e sigurisë së bankës dhe klientëve të saj.

Procesi ynë NjKT (Njih Klientin Tuaj) përcakton politikat e Grupit BNP Paribas lidhur me njohuritë për klientët, duke ndihmuar në zbatimin e politikave dhe efikasitetin operacional. Ai përfshin një plan kontrolli dhe metriqë, duke ndjekur procedurat bankare dhe ligjet e Kosovës. Funksioni ynë i Pajtuëshmërisë, qëndror për Menaxhimin e Rrezikut dhe Kontrollin e Brendshëm TEB S.H.A., bashkëpunon me palët kryesore të interesit dhe ofron këshillim ekspertësh për respektimin e sanksioneve. Procedurat dhe trajnimet tona sigurojnë që banka jonë t'u përmbahet ligjeve, rregulloreve dhe standardeve të industrisë, duke siguruar pajtuëshmëri me Ligjin PPP/LFT në Kosovë, Rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, standardizimin e proceseve për efikasitet, ofrimin e trajnimeve dhe udhëzimin e punonjësve të bankës për zbutjen e rreziqeve të pajtuëshmërisë.

Ne jemi të përkushtuar t'u përmbahemi ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve strikte për të luftuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, për të parandaluar shkeljen e sanksioneve financiare ndërkombëtare. Për më tepër, banka dokumentoi politika dhe procedura në përputhje me rregulloret dhe kërkesat e zbatueshme kundër rryshfetit dhe korrupsionit për të parandaluar, zbuluar dhe raportuar rryshfetin dhe korrupsionin.

Në vitin 2024 ne patëm përparim në fusha të ndryshme të pajtuëshmërisë, të cilat forcojnë më tej strukturën tonë të pajtuëshmërisë, veçanërisht për PPP/LFT. Ne vazhduam forcimin e kornizës sonë të sanksioneve për të adresuar sfidat gjeopolitike në zhvillim dhe përmirësuam procesin tonë NjKT me përmirësime të tilla si verifikimi i rregullt i lajmeve negative.

Në vijim janë radhitur arritjet kryesore të Pajtuëshmërisë për vitin 2024:

- Misione të ndryshme për Sigurinë Financiare janë menaxhuar nga Pajtuëshmëria, duke rezultuar në rezultate të kënaqshme
- Qëndrueshmëria e pajtuëshmërisë së kornizës së qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit në lidhje me Sigurinë Financiare është fuqizuar më tej
- Pajtuëshmëria mbështet në mënyrë konsistente dhe të vazhdueshme Linjën e Biznesit duke mbetur e qëndrueshme në Parimin e Pajtuëshmërisë
- Ne kemi mirëmbajtur qasjen bankare në përputhje me kërkesat e Rregulloreve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Njësisë së Inteligjencës Financiare të Republikës së Kosovës dhe parimeve të Grupit BNP Paribas.
- Përcaktimi i Pajtuëshmërisë për PPP është përforcuar ndjeshëm.

Qëllimet dhe objektivat për vitin 2025 janë si vijon:

- Në përputhje me parimet e Grupit BNP Paribas, si dhe kërkesat rregullative lokale nga BQK-ja dhe NjIF, pajtuëshmëria do të mbetet prioriteti kryesor i Bankës
- Ne do të vazhdojmë të ndjekim Planin BNP Paribas GTS 2025 i cili na siguron një bazë solide për të arritur objektivat tona të pajtuëshmërisë dhe për ta bërë kornizën tonë edhe më efektive
- Mbajtja e ndërgjegjësimit dhe nivelit të trajnimit të stafit për temat që lidhen me Pajtuëshmërinë, veçanërisht ato që lidhen me PPP/LFT
- Fuqizimi i zgjidhjeve aktuale të zbulimit të automatizuar të PPP-së për të qenë në koherencë me tendencat e reja në PPP (Parandalimi i Pastrimit të Parave) / LFT (Luftimi i Financimit të Terrorizmit) / KRK (Kundër Rryshfeti dhe Korrupsioni) dhe Sanksionet Financiare Ndërkombëtare
- Parashikimi i mobilitetit dhe menaxhimi i personelit të pajtuëshmërisë për të mbajtur një strukturë të qëndrueshme të pajtuëshmërisë
- Sigurimi që të ketë komunikim të rrjedhshëm brenda ekipeve tona të pajtuëshmërisë, ekipeve të BNP Paribas dhe TEB A.S Turqisë
- Mbështetja e Linjës së Biznesit në vendosjen e kontrolleve, politikave dhe procedurave, raportimit dhe proceseve të reja
- Ne do të përshpejtojmë rregullimin e shtyllave të kontrollit dhe vlerësimit të rrezikut të kornizës tonë të menaxhimit të rrezikut të pajtuëshmërisë, si dhe infrastrukturës përkatëse të mjetit në bashkëpunim të ngushtë me BNP Paribas për të mbikëqyrur në një mënyrë më efektive rreziqet tona të pajtuëshmërisë
- Ne jemi të vendosur të rrisim efikasitetin e modeleve operative të proceseve tona kryesore të Pajtuëshmërisë, veçanërisht në lidhje me luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, korrupsionit dhe parandalimin e shkeljes së sanksioneve financiare ndërkombëtare dhe embargoeve.
- Banka jonë do të vazhdojë politikat e saj të kujdesshme të pajtuëshmërisë, duke ndjekur nga afër parimet tona të Grupit BNP Paribas
- Së fundi, ne do të vazhdojmë të rrisim efikasitetin në fushën e pajtuëshmërisë si prioriteti kryesor i Bankës, duke përdorur teknologjinë për të lehtësuar proceset pa kompromentuar nga konfigurimi i fuqishëm.

Pajtueshmëria Rregullative

Përgjegjësia kryesore e Departamentit të Pajtueshmërisë Rregullative, në përputhje me strategjinë e Bankës për të qenë një bankë në pajtueshmëri, është të identifikojë, vlerësojë dhe monitorojë rreziqet e pajtueshmërisë rregullative me të cilat përballlet Banka. Departamenti raporton drejtpërdrejtë tek Komiteti i Auditimit / Bordi i Drejtorëve, i informon ata për këto rreziqe dhe ndjek masat korrigjuese kur është e nevojshme. Për më tepër, Departamenti këshillon Menaxhmentin e Lartë në lidhje me temat e Pajtueshmërisë përmes opinioneve, rishikimit të kornizës operationale dhe planit të procesit. Departamenti i Pajtueshmërisë Rregullative operon në baza proaktive duke vlerësuar rreziqet e Pajtueshmërisë Rregullative që lidhen me aktivitetet e biznesit të bankës, duke përfshirë zhvillimin e produkteve të reja.

Fokusi kryesor është në kërkesat rregullative të Bankës Qendrore të Kosovës dhe kërkesat e politikave të BNPP-së, prandaj procesi i mbikëqyrjes rregullative ka qenë shumë aktiv gjatë vitit 2024, ka monitoruar të gjitha ndryshimet në kornizën rregullative dhe ka krijuar plane veprimi për palët e interesit.

Gjatë vitit 2024, Departamenti ka zbatuar plotësisht Prioritetet Globale të Grupit dhe, për të rrënjosur më tej kulturën e Pajtueshmërisë tek punonjësit, ka realizuar fushata sensibilizuese duke theksuar bazën themelore të udhëzimit drejt një bankimi etik dhe të kujdesshëm.

Baza themelore e udhëzimit drejt bankimit etik dhe të kujdesshëm është Kodi i Sjelljes së Grupit. Ky ka shpjegime të detajuara të temave si: Mbrojtja e Interesit të Klientëve, Siguria Financiare, Integriteti i Tregut, Etika Profesionale, Respekti për Kolegët, Përfshirja në Shoqëri dhe Mbrojtja e Grupit. Departamenti është përgjegjës për të siguruar që të gjithë punonjësit të jenë të informuar dhe të respektojnë Kodin e Sjelljes së Grupit.

Për më tepër, fushatat me material trajnimi u përcjellën nga tema më të hollësishme si Konfliktet e Interesit, Ftesa për Dhurata dhe deklarata të tjera të favorshme, Zyrat Personale dhe Interesat e Jashtme të Biznesit, si dhe në lidhje me rëndësinë e Sinjalizimit (Whistleblowing) dhe trajtimin e sinjalizimeve.

Në vitin 2024, Departamenti i Pajtueshmërisë Rregullative ka zbatuar po ashtu kornizën e Rrezikut të Reputacionit, duke përfshirë rrezikun e reputacionit në komitetet vendimmarrëse.

Për vitin 2025, një nga prioritetet do të jetë zbatimi i kërkesave rregullative në kuadër të anëtarësimit të Kosovës në Zonën e vetme të pagesave në Euro (SEPA - Single Euro Payment Area).

Departamenti i Pajtueshmërisë Rregullative punon ngushtë me Bankën Qendrore të Kosovës dhe Grupin BNPP për të zbatuar standardet më të larta të pajtueshmërisë, etikës dhe integritetit, duke mbrojtur gjithmonë interesat e klientëve.

Kontrolli i Brendshëm

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm në TEB SH.A. është i përkushtuar për të forcuar, mbështetur dhe mirëmbajtur kontrollet e brendshme duke rritur kulturën e kontrollit në të gjitha nivelet e organizatës. Funkcionet e Kontrollit të Brendshëm dhe të Rrezikut Operacional në TEB janë të strukturuar ndarazi. Departamenti i Kontrollit të Brendshëm, një organ i pavarur, i raporton drejtpërdrejtë Bordit të Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të Auditimit çdo tre-mujor. Ai është një komponent thelbësor i linjës së dytë të mbrojtjes dhe i kryen përgjegjësitë e tij në përputhje me këtë rol.

Kontrollet janë planifikuar për:

- Verifikimin e respektimit të duhur të rregullave dhe procedurave të brendshme dhe konsistencën dhe përputhjen e rregullave të brendshme me rregulloret ligjore,
- Kontributin në ruajtjen e aseteve,
- Vlerësimin e përshtatshmërinë, efektivitetit dhe efikasitetit të operacioneve ditore,
- Kontributin në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me aktivitetet e biznesit aktual dhe të propozuar të organizatës në të ardhmen, duke përfshirë produktet e reja.

Theksi kryesor i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm do të jenë kontrollet brenda në degë dhe kontrollet e përhershme nga Grupi. Për më tepër, aktivitetet e kontrollit në linjën e parë të mbrojtjes do të jenë një fushë tjetër fokusi për të rritur dhe përmirësuar efektivitetin dhe cilësinë e kontroleve të nivelit të parë.

Ligjorja

Funksioni LIGJOR si një funksion i integruar i Grupit mbikëqyr të gjitha rreziqet ligjore të Bankës, duke siguruar qëndrueshmëri në politikat dhe marrëveshjet e saj dhe duke ofruar këshilla ligjore për të gjitha funksionet e bankës. Grupi ka krijuar disa aktivitete thelbësore për të cilat funksioni LIGJOR është përgjegjës për të siguruar qasjen uniforme dhe bashkëpunuese të LIGJORES (d.m.th. procesi i Vëzhgimit Rregullativ (i cili zhvillohet në nivel lokal, rajonal dhe global), procesi i Standardizuar i Menaxhimit të Kontratës, menaxhimi i mos-marrëveshjeve ligjore, aktiviteti këshillues, aktiviteti i menaxhimit të Rrezikut Ligjor). Funksioni LIGJOR është dukshëm i pavarur dhe kryen kontrollet e tij të nivelit të parë dhe të dytë, vlerësimin e tij të rrezikut dhe ka buxhetin e vet.

Gjatë vitit të kaluar, Departamenti Ligjor vazhdoi të kontribuojë pozitivisht për Bankën, në garantimin që produkti i ri i saj ofron eliminimin e rrezikut ligjor dhe në rritjen e efikasitetit të punës operacionale të Bankës. Kontestet ligjore vazhdojnë të mbeten shumë të ulëta, dhe Departamenti Ligjor vazhdon të zgjidhë shumicën e kontesteve para se të shkojë në gjykatë.

Për vitin e ardhshëm, Departamenti Ligjor i Bankës planifikon të fokusohet në dhënien e kontributit në planin e Bankës për të ofruar pothuajse të gjitha produktet e saj të kredisë nga distanca, përmes aplikacioneve të saj të mobile banking (bankimit përmes celularit). Kjo përfshin vlerësimin e rrezikut ligjor të shërbimeve në distancë (identifikimi elektronik dhe nënshkrimet), si dhe sigurimin që nuk ka pengesa në zbatimin e marrëveshjeve elektronike.

RAPORTIMI I AUDITORËVE

**TEB SH.A. Pasqyrat financiare të përgatitura në pajtueshmëri
me Standardet e Kontabilitetit (SNRF) më dhe për vitin qëpër-
fundon më 31 dhjetor 2024**

PASQYRA E PËRMBAJTJES

Raporti i Auditorit të Pavarur	i
--------------------------------------	---

Pasqyrat financiare

Pasqyra e pozitës financiare	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të hyra të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.....	3
Pasqyra e rrjedhave së parasë	4

Shënime mbi pasqyrat financiare:

1 Hyrje	5
2 Përmbledhje e informacioneve të politikave materiale të kontabilitetit.....	5-17
3 Vlerësimet kritike dhe gjykimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit	18-21
4 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale	22-23
5 Paratë e gatshme dhe bilancet me banka.....	24
6 Kredi dhe paradhënie për banka	25-26
7 Investimet në letrat me vlerë të borxhit në vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	26-27
8 Kredi dhe paradhënie për klientë.....	28-36
9 Pronat e investimeve.....	36-37
10 Pasuritë e tjera financiare	37
11 Pasuritë e tjera	38
12 Pronat dhe pajisjet	38
13 Pasuritë me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë.....	39
14 Pasuritë e paprekshme	40
15 Depozitat e klientëve	40
16 Detyrimet e tjera financiare.....	41
17 Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat e tjera	41
18 Detyrimet e tjera.....	41
19 Kapitali aksionar.....	41
20 Të ardhurat nga interesi	42
21 Shpenzimet e interesit.....	42
22 Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	42
23 Shpenzime nga tarifat dhe komisionet.....	43
24 Shpenzimet e tjera operative	43
25 Humbjet dhe provizionet e tjera nga zhvlerësimi	43
26 Kostot e personelit.....	43
27 Shpenzimet administrative dhe shpenzimet e tjera operative.....	44
28 Tatimi në të ardhura.....	44-45
29 Shpalosjet e palëve të ndërlidhura	46-47
30 Zotimet dhe rastet e paparashikuara	48-50
31 Menaxhimi i kapitalit.....	50
32 Menaxhimi i rrezikut financiar.....	51-65
33 Shpalosjet e vlerës së drejtë	65-67
34 Paraqitja e instrumenteve financiare sipas kategorisë së matjes	67-69
35 Ngjarjet pas përfundimit të periudhës së raportimit	70



**Building a better
working world**

Ernst & Young Certified Auditors
Ltd - Kosovo
Rr. Bajram Kelmendi 92 3rd floor
Prishtine, Kosove

Tel: +383 38 220 155
Fax: +383 38 220 151
ey.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin e TEB SH.A. në Kosovë

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **TEB SH.A.** në Kosovë (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë informacionin material të politikave të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2024, dhe të rezultatit të saj financiar dhe rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet e Kontabilitetit SNRF ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarsisë) ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor të viti 2024 të TEB SH.A.

Informacione të tjera përbëhen nga informacionet e përfshira në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-093, përveç pasqyrave financiare dhe raportit të auditorit tonë për to. Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor 2024 i Bankës pritet të na vihet në dispozicion, pas datës së raportit të auditorit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet e Kontabilitetit SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare (vazhdim)

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e TEB SH.A., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k.

Ernst & Young Kosovo
12 Mars 2025
Prishtinë, Kosovë

Mario Vangjeli
Auditor Ligjor



TEB SH.A.**Pasqyra e pozitës financiare***(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)*

	Shënim	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
PASURITË			
Paratë e gatshme dhe bilancet me banka	5	139,705	112,225
Kreditë dhe paradhëniet për banka	6	86,299	102,560
Letrat me vlerë të borxhit në vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	7	31,167	21,535
Kredi dhe paradhënie për klientë	8	719,007	598,079
Pronat e investimeve	9	2,080	2,035
Pasuritë e tjera financiare	10	7,189	8,086
Pasuritë e tjera	11	1,963	1,643
Objektet dhe pajisjet	12	5,079	4,559
Pasuritë me të drejtë përdorimi	13	5,631	5,214
Pasuritë e paprekshme	14	2,997	2,800
GJITHSEJ PASURITË		1,001,117	858,736
DETYRIME			
Depozitat e klientëve	15	846,175	722,942
Detyrime të tjera	18	776	992
Detyrimet e qirasë	13	5,738	5,281
Detyrimet e tjera financiare	16	8,707	12,312
Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat	17	835	1,035
Detyrimet e tatimit në të ardhura të korporatës		223	681
Detyrimet e tatimit të shtyrë	28	116	51
GJITHSEJ DETYRIMET		862,570	743,294
EKUITETI I AKSIONARËVE			
Kapitali aksionar	19	24,000	24,000
Fitimet e mbajtura		113,863	91,333
Rezervat e tjera		684	109
GJITHSEJ EKUITETI I AKSIONARËVE		138,547	115,442
GJITHSEJ DETYRIMET DHE EKUITETI I AKSIONARËVE		1,001,117	858,736

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Menaxhmenti Ekzekutiv i Bankës më 10 mars 2025 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:


Z. Orçun Özdemir
Drejtör Menaxhues


Z. Rezak Fetai
Zyrtar Kryesor Financiar

Shënimet në faqet 5 deri në 70 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse***(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)*

	Shënim	2024	2023
Të ardhurat nga interesi në normën efektive të interesit	20	49,843	42,060
Shpenzimet e interesit	21	(1,303)	(740)
Neto marzha në interes dhe të ardhurat e ngjashme		48,540	41,320
Shpenzimet nga humbjet e kredive	8	(980)	(613)
Neto marzha në interes dhe të ardhurat e ngjashme pas përfshirjes së humbjeve të pritura nga kreditë		47,560	40,707
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	22	20,554	17,777
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet	23	(8,679)	(7,224)
Të hyrat neto nga tarifat dhe komisionet		11,875	10,553
Të ardhurat neto operative		59,435	51,260
Neto fitimet/(humbjet) nga transaksionet dhe rivlerësimi i valutave të huaja		583	511
Neto fitimet/(humbjet) në rivlerësimin e pronës së investimeve		45	115
Të ardhurat e tjera operative		422	355
Shpenzime të tjera operative	24	(2,307)	(1,873)
Humbjet dhe provizionet e tjera nga zhvlerësimi	25	(272)	(534)
Kostot e personelit	26	(11,482)	(10,057)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13,14	(6,116)	(4,953)
Shpenzimet administrative	27	(10,748)	(9,301)
FITIMI PARA TATIMIT		29,560	25,523
Shpenzimet e tatimit në të ardhura	28	(2,530)	(2,623)
FITIMI I VITIT		27,030	22,900
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse/(humbjet)			
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse që do të riklasifikohen në pasqyrën e fitimit dhe humbjes			
Letrat me vlerë të borxhit në vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:		575	630
Gjithsej të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse e vitit		575	630
GJITHSEJ TË ARDHURAT		27,605	23,530
GJITHËPËRFSHIRËSE TË VITIT			

Shënimet në faqet 5 deri në 70 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.**Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet***(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë EUR, nëse nuk është shënuar ndryshe)*

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2023	24,000	70,933	(521)	94,412
Fitimi i vitit		22,900		22,900
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			630	630
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	22,900	630	23,530
Dividenda e paguar		(2,500)		(2,500)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	24,000	91,333	109	115,442
Gjendja më 1 janar 2024	24,000	91,333	109	115,442
Fitimi i vitit		27,030		27,030
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			575	575
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	27,030	575	27,605
Dividenda e paguar		(4,500)		(4,500)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	24,000	113,863	684	138,547

Shënimet në faqet 5 deri në 70 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.
Pasqyra e rrjedhës së parasë
(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënime	2024	2023
Rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		29,560	25,523
<i>Rregullimet për:</i>			
Zhvlerësimi i objekteve dhe pajisjeve	12	1,995	1,614
Zhvlerësimi i pasurive me të drejtë përdorimi	13	1,272	1,306
Amortizimi i pasurive të paprekshme	14	2,849	2,033
Neto fitimet në shitjen e objekteve dhe pajisjeve		(50)	(11)
Fitimi nga vlera e drejtë e pronës së investimeve		(45)	(115)
Fitimet në Investimet në letrat me vlerë		53	(13)
Humbjet e pritshme kreditore	8,17	2,062	2,348
Humbjet e pritshme kreditore të pasurive të tjera financiare dhe zotimet e lidhura me kreditë	24,17	83	66
Provizione të ndryshme	24	288	623
Të ardhurat nga interesi	20	(49,843)	(42,060)
Shpenzimet e interesit	21	1,303	740
		(10,473)	(7,946)
<i>Neto ulja/(rritja) në:</i>			
Rezerva e detyrueshme e BQK-së		(11,815)	(3,024)
Kredi dhe paradhënie për klientë		(122,500)	(65,139)
Pasuritë e tjera financiare		362	(2,089)
Pasuritë e tjera		(469)	(213)
<i>Neto rritja/(ulja) në:</i>			
Depozitat e klientëve		122,882	71,601
Detyrimet e tjera financiare		(3,605)	2,996
Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat		(200)	221
Detyrime të tjera		13	144
		(15,332)	4,497
Interesi i arkëtuar		49,339	41,869
Interesi i paguar		(952)	(698)
Tatimi mbi të ardhura i paguar		(2,987)	(2,395)
Rrjedhat e parave të gatshme neto nga aktivitetet operative		19,595	35,327
Rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet investuese			
Blerja e letrave me vlerë në vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		(19,706)	-
Të ardhurat nga shitja ose maturiteti i investimeve në letrat me vlerë të borxhit		10,852	20,757
Të hyrat nga shitja e objekteve dhe pajisjeve		59	33
Fitimet nga investimet në letrat me vlerë të borxhit		-	-
Blerja e objekteve dhe pajisjeve	12	(2,526)	(2,319)
Blerja e pasurive të paprekshme	14	(3,046)	(2,363)
Rrjedhat e parasë së gatshme neto të përdorura në aktivitetet investuese		(14,367)	16,108
Rrjedha e parasë së gatshme nga aktivitetet financuese			
Pagesa e dividendës		(4,500)	(2,500)
Pagimi i kryegjësë së detyrimeve të qirasë		(1,383)	(1,393)
Rrjedhat e parasë së gatshme neto nga/të përdorura në aktivitetet investuese		(5,883)	(3,893)
Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve të parave		(655)	47,542
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		149,486	101,944
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	5	148,831	149,486

Shënimet në faqet 5 deri në 70 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1 HYRJE

TEB SH.A. ("Banka") është themeluar në Republikën e Kosovës më 19 dhjetor 2007, kur edhe iu dha licenca për veprimtari bankare nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"). Banka filloi veprimtarinë në janar 2008.

Banka kontrollohet nga TEB Holding AS, që është shoqëri e themeluar në Turqi ("Kompania amë"), e cila zotëron 100% të aksioneve të bankës. Aksionarët e TEB Holding AS janë BNP Paribas dhe Grupi Çolakoğlu, ku secili prej tyre ka në pronësi 50% të aksioneve. BNP Paribas është pala e fundit kontrolluese e kompanisë amë dhe e Bankës.

Adresa e regjistruar dhe vendi i biznesit: Zyra qendrore e regjistruar e Bankës gjendet në Preoc p.n. KM7, magjistratja Prishtinë-Ferizaj, Graçanicë 10500, Republika e Kosovës.

Aktiviteti kryesor: Banka vepron si bankë me të drejta të plota, në përputhje me Ligjin Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe ofron shërbime për të gjitha kategoritë e klientëve në Republikën e Kosovës, përmes rrjetit të saj prej 34 degësh kryesore (2023: 30) që gjenden në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

Më 31 dhjetor 2024, Bordi i Drejtorëve të Bankës përbëhet nga:

- Ayşe Aşardağ (Kryesuese)
- Luc Delvaux (Zëvendëskryesues)
- Alp Yilmaz (Zëvendëskryesues)
- Nimet Elif Kocaayan (Anëtare)
- Osman Durmuş (Anëtar)
- Nilsen Altıntaş (Anëtar)
- Patrick Poupon (Anëtar)
- Esra Peri Aydoğan (Anëtare)
- Fatma Gülden Yüncüoğlu (Anëtare)
- Orçun Özdemir (Anëtar dhe Drejtor Menaxhues)
- Oya Gökçen (Anëtare)
- Hakan Tıraşın (Anëtar)

2 PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT

Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me SNRF Standardet e Kontabilitetit siç lëshohen nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"), sipas bazës së kostove historike përveç vlerësimit të pronave të investimeve dhe instrumenteve financiare të kategorizuara me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes ("VDPFH") dhe me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGj"). Banka nuk ka asnjë instrument financiar derivativ ose zë të mbrojtur që do të matej me vlerën e drejtë.

Politikat kryesore kontabël të zbatuara gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë aplikuar vazhdimisht në të gjitha periudhat e paraqitura, nëse nuk është thënë ndryshe.

Valuta funksionale edhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në EUR, e cila është valuta funksionale e bankës. Valuta funksionale është valuta primare e mjedisit ekonomik në të cilin Banka e ushtron veprimtarinë e saj, që është Republika e Kosovës.

2 PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Lista e shkurtesave të përdorura në këto pasqyra financiare është dhënë më poshtë:

Shkurtesa	Emri i plotë
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
Grupi TEB	TEB Holding AS
Grupi	BNP Paribas
BiD	Bordi i Drejtorëve
IFRS	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
NEI	Norma efektive e interesit
NI	Norma e interesit
RrNI	Rreziku i normës së interesit
PNN	Pasuritë e ndjeshme ndaj normës
DNN	Detyrimet e ndjeshme ndaj normës
Pasuritë financiare ZHBK	Pasuritë financiare të zhvlerësuar në blerje ose në krijim
KA	Kosto e amortizuar
VDATGj	Vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
VDPFH	Vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes
PM	Probabiliteti i mospagesës
DR	Normat e mospagesës
EnM	Ekspozimi në mospagesë
DnV	Ditë në vonesë
HPK	Humbja e pritur nga kreditë
HPKJ	Humbja e pritur nga kreditë përgjatë jetëgjatësisë
HpMP	Humbja për mospagesë
RrKRrK	Rritja e konsiderueshme e rrezikut kreditor
VPKI	Vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit
Testi i VPKI-së	Vlerësimi nëse rrjedhat parave të gatshme e instrumenteve financiare përbëjnë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit
FKK	Faktori i Konvertimit të Kredisë
ALEP	Agjentëve lokalë të ekzekutimit privat
ZKF	Zyrtar Kryesor Financiar
ZKRr	Zyrtar Kryesor i Rrezikut
MPD	Menaxhimi i pasurive-detyrimeve
KPD	Komitetet e pasurive-detyrimeve
KLVD	Komiteti i listës së kredive vrojtuese dhe të dyshimta
RML	Raporti i mbulimit të likuiditetit
RNFQ	Raporti neto i financimit të qëndrueshëm

Instrumentet financiare - Afatet kyçe të matjes

Varësisht nga klasifikimi, instrumentet financiare mbahen në vlerën e drejtë ose në koston e amortizuar siç përshkruhet më poshtë.

Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për shitjen një pasuri ose që do të paguhej për ta transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në tregun kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Treg aktiv është ai ku transaksionet për pasurinë ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informata të çmimeve në mënyrë të vazhdueshme.

2 PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Kur mundet, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Nëse nuk ka çmim të kuotuar, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e faktorëve përkatës të vëzhgueshëm dhe minimizojnë përdorimin e faktorëve jo të vëzhgueshëm.

Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh gjatë vendosjes së çmimit të një transaksioni.

Teknikat e vlerësimit, siç janë modelet e rrjedhave të skontuara të parasë ose modelet e bazuara në transaksionet e kohëve të fundit sipas kushteve të tregut ose marrjen në konsideratë të të dhënave financiare të palëve ku është investuar, përdoren për ta matur vlerën e drejtë të disa instrumenteve financiare për të cilët informacioni për çmimet e tregut të jashtëm nuk është në dispozicion. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për pasuritë ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale të vëzhgueshme për pasurinë ose detyrimin, ose drejtpërdrejt (si psh çmimet) ose tërthorazi (që buron nga çmimet) dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk janë të bazuara vetëm në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (do të thotë matja kërkon inpute të konsiderueshme që nuk mund të vëzhgohen). Transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë vlerësohet se nuk kanë ndodhur në fund të periudhës së raportimit.

Kostot e transaksionit janë kosto progresive të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, emetimin ose heqjen nga përdorimi të një instrumenti financiar. Një kosto progresive është ajo kosto e cila nuk do të kishte ndodhur nëse as transaksioni nuk do të kishte ndodhur. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifat dhe komisionet që u paguhen agjentëve (duke përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë shitës), këshilltarët, ndërmjetësit dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullative dhe bursat e letrave me vlerë si dhe taksat dhe detyrimet e transferit. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e borxheve ose zbritjet, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose të mbajtjes.

Kostoja e amortizuar është shuma me të cilën instrumenti financiar matet në njohjen fillestare, minus pagimet e kryegjësë, plus interesi i akumuluar, dhe për pasuritë financiare, minus çdo rezervë e prituri e humbjes nga kreditë. Interesi i akumuluar përfshin amortizimin e koston së shtyrë të transaksionit në njohjen fillestare dhe çdo prim ose zbritje në shumën e maturimit, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të ardhurat e interesit të akumuluar dhe shpenzimet e interesit të akumuluar, duke përfshirë edhe interesin e akumuluar dhe zbritjen ose primin e amortizuar (duke përfshirë tarifat e shtyra fillestare, nëse ka) nuk paraqiten të ndara dhe përfshihen në vlerat bartëse të zërave përkatës në pasqyrën e pozitës financiare.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e alokimit të të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit). 'Norma efektive e interesit' është norma që zbret saktësisht pranimet e ardhshme të parasë së gatshme ose nëpërmjet jetës së prituri të instrumentit financiar.

- Për pasuritë financiare përveç atyre të zhvlerësuar në blerje ose në krijim (d.m.th. pasuritë që janë kredi të zhvlerësuar në njohjen fillestare), norma efektive e interesit është norma që i skanton pranimet e ardhshme të parasë së gatshme duke përfshirë humbjet e prituri të kredisë, përmes jetës së prituri të instrumentit të borxhit, ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër, ndaj shumës bartëse bruto të instrumentit të borxhit në njohjen fillestare.
- Për pasuritë financiare për të cilat ka një humbje kredie (pasuritë e zhvlerësuar në fazën 3), norma efektive e interesit zbatohet për koston e amortizuar të tij dhe jo për shumën e tij bartëse bruto.
- Për detyrimet financiare, norma efektive e interesit është norma që skanton pagesat e ardhshme të parave të gatshme në koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin kostot e transaksionit, tarifat si dhe pagesat e paguara ose të pranuar që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit.

Norma efektive e interesit i skanton rrjedhat e parave të instrumenteve të interesit të ndryshueshëm në datën vijuese të rivendosjes së çmimit të interesit, përveç premiumit ose zbritjes, që pasqyron shpërndarjen e kreditit mbi normën e ndryshueshme të specifikuar në instrument, ose variablat e tjera që nuk janë rivendosur në normat e tregut. Premiumet ose zbritjet e tilla amortizohen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit.

2 PERMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Instrumentet financiare - njohja fillestare

Instrumentet financiare në VDPFH fillimisht regjistrohen në vlerën e drejtë. Të gjitha instrumentet e tjera financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Banka llogarit atë instrument në atë datë si më poshtë:

- Një fitim ose humbje në njohjen fillestare regjistrohet vetëm nëse ka diferencë ndërmjet vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të dëshmohet me transaksionet e tjera të vëzhgueshme të tregut aktual me të njëjtin instrument ose me një teknikë vlerësimi, inputet e së cilës përfshijnë vetëm të dhënat nga tregjet e vëzhgueshme.
- Në të gjitha rastet e tjera, matja e vlerës së drejtë rregullohet për të bartur diferencën për më vonë. Pas njohjes fillestare, Banka e njeh atë diferencë të shtyrë si fitim ose humbje vetëm për aq sa paraqitet nga një ndryshim në një faktor (përfshirë kohën) që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh gjatë vendosjes së çmimeve të pasurive ose detyrimeve.

Pas njohjes fillestare, një rezervë e HPK njihet për pasuritë financiare të matura në KA dhe investimet në instrumentet e borxhit të matur në VDATGj, që rezultojnë në një humbje të menjëhershme kontabël.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e pasurive financiare që kërkojnë dorëzim brenda afatit kohor të përcaktuar me rregullore ose konventë të tregut (blerjet dhe shitjet në mënyrë të rregullt) regjistrohen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Banka zotohet për ta dhënë një pasuri financiare. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur Banka bëhet palë në provizione kontraktuale të instrumentit.

Pasuritë financiare - klasifikimi dhe matja pasuese - kategoritë e matjes

Banka i klasifikon pasuritë financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDPFH, VDATGj dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e pasurive financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i Bankës për menaxhimin e portofolit të pasurive përkatëse dhe (ii) karakteristikat e rrjedhës së parave të pasurisë.

Pasuritë financiare - klasifikimi dhe matja pasuese – modeli i biznesit

Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Banka i menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojnë rrjedha të parave - nëse objektivi i Bankës është: (i) vetëm për të mbledhur rrjedha kontraktuale të parave nga pasuritë ("të mbajtura për të mbledhur rrjedha kontraktuale të parave") ose (ii) për të mbledhur edhe rrjedha kontraktuale të parave edhe rrjedhat e parave që vijnë nga shitja e pasurive ("të mbajtura për të mbledhur rrjedha kontraktuale të parave dhe për shitje") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk zbatohet, pasuritë financiare klasifikohen si pjesë e modelit "tjetër" të biznesit dhe maten në VDPFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për një grup të pasurive (në nivel të portfolios) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse në lidhje me aktivitetet që Banka i merr përsipër ta arrijë objektivin e përcaktuar për portfolion në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që i merr në konsiderim Banka në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë qëllimin dhe përbërjen e portfolios, përvojën e kaluar për mënyrën se si janë arkëtuar rrjedhat e parave për pasuritë përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e pasurive dhe si kompensohen menaxherët. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike që i ka zbatuar Banka në përcaktimin e modeleve të biznesit për pasuritë e saj financiare.

Pasuritë financiare - klasifikimi dhe matja pasuese - karakteristikat e rrjedhës së parave

Kur modeli i biznesit është që të mbahen pasuritë për të mbledhur rrjedha të parave kontraktuale ose për të mbledhur rrjedha të parave kontraktuale dhe për shitje, Banka vlerëson nëse rrjedhat e parave përfaqësojnë VPKI-në. Pasuritë financiare me derivativë të përfshirë konsiderohen në tërësinë e tyre kur përcaktohet nëse rrjedhat e tyre të parave janë në përputhje me tiparin e VPKI. Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Banka shqyrton nëse rrjedhat kontraktuale të parave janë në përputhje me një marrëveshje bazë të kredidhënies, përkatësisht nëse interesi përfshin vetëm kompensimin për rrezikun kreditor, vlerën kohore të parave, rreziqet e tjera bazë të kredidhënies dhe marzhin e fitimit.

Kur afatet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose luhatshmëri që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të kredidhënies, pasuria financiare klasifikohet dhe matet në VDPFH. Vlerësimi i VPKI kryhet në njohjen fillestare të një pasurie dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike që i ka zbatuar Banka në kryerjen e testit VPKI për pasuritë e saj financiare.

2 PERMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Pasuritë financiare - riklasifikimi

Pasuritë financiare riklasifikohen vetëm kur ndryshon modeli i biznesit për menaxhimin e portfolios në tërësi. Riklasifikimi ka efekt të ardhshëm dhe zhvillohet që nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që vijon pas ndryshimit të modelit të biznesit. Banka nuk e ka ndryshuar modelin e saj të biznesit gjatë periudhës aktuale dhe krahasuese dhe nuk ka bërë ndonjë riklasifikim.

Zhvlerësimi i pasurive financiare –rezerva për humbjet e pritura kreditorë

Banka i vlerëson HPK për instrumentet e borxhit të matura në KA dhe VDATGJ dhe për ekspozimet që rrjedhin nga zotimet kreditorë dhe kontratat e garancive financiare. Banka e mat HPK-në dhe i njeh rezervat për humbjet kreditorë në çdo datë raportimi. Matja e HPK pasqyron: (i) një shumë të paanshme dhe të ponderuar në bazë të probabilitetit që përcaktohet duke shqyrtuar rezultate të ndryshme të mundshme, (ii) vlerën kohore të parasë dhe (iii) të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe që mund të mbështetet me dëshmi që është në dispozicion pa kosto dhe përpjekje të panevojshme në fund të secilës periudhë raportuese për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme.

Instrumentet e borxhit të matur në KA janë paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare neto nga rezerva e HPK. Për zotimet e kredive dhe garancitë financiare, një provizion i veçantë për HPK njihet si detyrim në pasqyrën e pozitës financiare. Për instrumentet e borxhit sipas VDATGj, ndryshimet në koston e amortizuar, neto nga rezerva për HPK, njihen në fitim ose humbje dhe ndryshimet e tjera në vlerën bartëse njihen në ATGJ si fitime minus humbjet në instrumentet e borxhit në VDATGj.

Banka përdor një model prej tre fazash për zhvlerësim, bazuar në ndryshimet në cilësinë kreditorë që nga njohja fillestare. Një instrument financiar që nuk është i zhvlerësuar në njohjen fillestare klasifikohet në Fazën 1. Pasuritë financiare në Fazën 1 e kanë HPK-në e tyre të matur me 12 muaj ose deri në maturimin kontraktual, nëse është më e shkurtër ("HPK 12-Mujore"). Nëse Banka identifikon një RrKRrK që nga njohja fillestare, pasuria transferohet në Fazën 2 dhe HPK e saj matet bazuar në HPK përgjatë jetëgjatësisë, do të thotë deri në maturimin kontraktual por duke marrë parasysh parapagimet e pritura, nëse ka ("HPK e tërë jetëgjatësisë").

Referojuni paragrafit të **Rritjes së konsiderueshme në rrezikun kreditor "RRKRrK"** për shpjegimin se si Banka e përcakton kur ka ndodhur një RrKRrK. Nëse Banka përcakton që një pasuri financiare është zhvlerësuar nga kredia, pasuria transferohet në Fazën 3 dhe HPK e saj matet si HPK e jetëgjatësisë. Përkufizimi i Bankës për pasuritë e zhvlerësuara dhe përkufizimi i dështimit për të paguar shpjegohen në.

Zhvlerësimin e pasurive financiare. Për pasuritë financiare që janë të zhvlerësuara në blerje ose në krijim ("pasuritë ZHBK"), HPK matet gjithmonë si HPK përgjatë jetëgjatësisë së pasurisë. Përgjashtimisht, për instrumente të caktuara financiare, të tilla si kartelat e kreditit, që mund të përfshijnë edhe kredi edhe një komponent të zotimit të pashfrytëzuar, Banka i mat humbjet e pritura kreditorë gjatë periudhës kur Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor, përkatësisht deri kur humbjet kreditorë të pritura do të ulen për shkak të veprimeve të menaxhimit të rrezikut kreditor, edhe nëse kjo periudhë zgjat përtej periudhës maksimale kontraktuale. Kjo për shkak se aftësia kontraktuale për ta kërkuar pagimin dhe anulimin e zotimit të pashfrytëzuar nuk e kufizon ekspozimin ndaj humbjeve kreditorë në një periudhë njoftimi të tillë kontraktuale.

Pasuritë financiare - shlyerja

Pasuritë financiare shlyhen sipas vonesave dhe mbulimit të kolateralit, siç përcaktohet nga rregullorja lokale. Nga ana tjetër, nëse Banka i ka harxhuar të gjitha përpjekjet e rimëkëmbjes dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka shpresa të arsyeshme për rimëkëmbje, ajo mund të vendosë ta shlyejë një pasuri para datës së përcaktuar me rregulloret lokale.

Pasuritë financiare – ç'regjistrimi

Banka çregjistron pasuritë financiare kur: (a) pasuritë janë shlyer ose të drejtat për rrjedhat e parave nga pasuritë kanë skaduar; ose (b) Banka ka transferuar të drejtat për rrjedhat e parave nga pasuritë financiare ose ka hyrë në një marrëveshje kalimtare, përderisa: (i) i ka transferuar në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurive; ose (ii) nuk i ka transferuar apo mbajtur të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk mban kontroll mbi to. Kontrolli ruhet nëse pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për t'ia shitur pasurinë në tërësi një pale të tretë të palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime në shitje, nuk ka aftësinë praktike t'ia shesë pasurinë në tërësi një pale të tretë të pandërlidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime në shitje.

2 PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Pasuritë financiare - modifikimi

Banka ndonjëherë rinegocion ose i modifikon afatet kontraktuale të pasurive financiare. Banka vlerëson nëse modifikimi i rrjedhve të parave kontraktuale është i konsiderueshëm duke marrë parasysh, ndër të tjera, faktorët e mëposhtëm: ndonjë afat të ri kontraktual që ndikon në mënyrë të konsiderueshme në profilin e rrezikut të pasurisë, ndryshim të konsiderueshëm të normës së interesit, kolateral i ri ose përmirësim kreditor që ndikon ndjeshëm në rrezikun kreditor që lidhet me pasurinë ose zgjatjen e konsiderueshme të një kredie kur huamarrësi nuk është në vështirësi financiare. Nëse afatet e modifikuara janë në thelb të ndryshme, të drejtat për rrjedhat e parave nga pasuria fillestare skadojnë dhe Banka e çregjistron pasurinë financiare fillestare dhe e njeh një pasuri të re me vlerën e vet të drejtë. Data e rinegocimit konsiderohet si data e njohjes fillestare për qëllimet e llogaritjes së zhvlerësimit pasues, duke përfshirë përcaktimin nëse ka ndodhur një RrKRrK. Banka gjithashtu vlerëson nëse kredia e re ose instrumenti i borxhit e plotëson kriterin e VPKI. Çdo ndryshim ndërmjet shumës bartëse të pasurisë fillestare të çregjistruar dhe vlerës së drejtë të pasurisë së re të modifikuar thelbësisht, njihet në fitim ose humbje, përveç nëse substanca e diferencës i atribuohet një transaksioni të kapitalit me pronarët.

Në një situatë kur rinegociimi u drejtua me vështirësi financiare të palës tjetër dhe pamundësia për të bërë pagesat e rena dakord fillimisht, Banka vlerëson nëse modifikimi i afateve është thelbësor apo jo. Nëse pasuria e modifikuar nuk është thelbësisht ndryshe nga pasuria fillestare, modifikimi nuk ka si rezultat çregjistrimin. Banka rillogarit shumën totale bruto duke përdorur normën efektive fillestare të interesit (ose normën efektive të interesit të korrigjuar sipas kredisë për pasuritë financiare 'ZHBK') dhe njeh një fitim ose humbje modifikimi në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Detyrimet financiare - kategoritë e matjes

Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas në kosto të amortizuar KA përveç (i) detyrimeve financiare në VDPFH: ky klasifikim zbatohet për detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozitat e shkurtra në letra me vlerë), vlerat kontingjente të njohura nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancive financiare dhe zotimet kreditore.

Detyrimet financiare - çregjistrimi

Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (kur detyrimi i specifikuar në kontratë përfundon, anulohet ose skadon). Një shkëmbim ndërmjet Bankës dhe huadhënësve të saj fillestarë të instrumenteve të borxhit me afate thelbësisht të ndryshme, si dhe modifikime thelbësore të afateve dhe kushteve të detyrimeve financiare ekzistuese, trajtohet si shlyerje e detyrimit financiar fillestar dhe njohja e një detyrimi të ri financiar. Afatet janë thelbësisht të ndryshme në qoftë se vlera aktuale e rrjedhve të parave sipas afateve të reja, duke përfshirë çdo pagesë të paguar neto nga çdo tarifë e marrë dhe zbritur duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv, është të paktën 10% ndryshe nga vlera aktuale e skontuar e rrjedhve të parave të detyrimit financiar fillestar. Nëse një shkëmbim i instrumenteve të borxhit ose modifikimi i afateve llogaritet si shuarje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar njihet si pjesë e fitimit ose humbjes në shlyerje.

Nëse shkëmbimi ose modifikimi nuk llogaritet si shuarje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar rregullon shumën bartëse të detyrimit dhe amortizohet gjatë afatit të mbetur të detyrimit të modifikuar.

Ndryshimet e detyrimeve që nuk rezultojnë në shlyerje llogariten si ndryshim në vlerësim duke përdorur një metodë kumulative kapëse, me çfarëdo fitimi ose humbjeje të njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes, përveç nëse përmbajtja ekonomike e diferencës në shumat bartëse i atribuohet një transaksioni kapital me pronarët.

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj janë pasuritë monetare që mund të konvertohen lehtësisht në para të gatshme në shuma të njohura të parasë dhe të cilat janë subjekt i një rreziku të papërfillshëm të ndryshimeve në vlerë. Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë të gjitha paratë e gatshme, plasmanet ndërbankare dhe depozitat e pakufizuara me BQK-në, me maturime fillestare më pak se tre muaj. Fondet e kufizuara për një periudhë origjinale të maturimit më të gjatë se tre muaj janë të përjashtuara nga paraja dhe ekuivalentët e saj. Paraja dhe ekuivalentët e saj barten në kosto të amortizuar sepse: (i) ato mbahen për grumbullimin e rrjedhve të parave kontraktuale dhe ato rrjedha të parave përfaqësojnë VPKI dhe (ii) nuk përcaktohen në VDPFH.

2 PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj (vazhdim)

Karakteristikat e kërkuara vetëm nga legjislacioni, siç është legjislacioni i shpëtimit në vende të caktuara, nuk kanë ndikim në testin e VPKI-së, përveç nëse ato janë të përfshira në afate kontraktuale në mënyrë që elementi të zbatohet edhe nëse legjislacioni më vonë ndryshohet.

Pagesat dhe pranimet në pasqyrën e rrjedhave të parasë përfaqësojnë transferet e parave dhe ekuivalentëve të tyre nga Banka, duke përfshirë shumat e ngarkuara ose kredituara në llogaritë rrjedhëse të klientëve, si të ardhurat nga interesi i kredisë, kryegjëja e arkëtuar, pagesat e interesit, ose disbursimet e kredive, që përfaqësojnë para ose ekuivalente nga perspektiva e klientit.

Gjendjet e detyrueshme të parave në BQK

Gjendjet e detyrueshme të parasë së gatshme në BQK barten në kosto të amortizuar dhe përfaqësojnë depozita të detyrueshme rezervë që nuk krijojnë interes dhe të cilat nuk janë në dispozicion për t'i financuar operacionet e përditshme të Bankës prandaj nuk konsiderohen si pjesë e parave dhe ekuivalentëve të saj për qëllimet e përgatitjes së pasqyrës së rrjedhës së parasë.

Detyrimet nga bankat e tjera (kredi dhe paradhënie bankave)

Shumat e detyrimeve nga bankat e tjera nënkuptojnë shumat kur Banka jep paradhënie për bankat e palës tjetër, pa pasur qëllim për ta tregtuar të arkëtueshmen e pakutuar jo-derivative, bazuar në data fikse ose të përcaktueshme. Shumat e detyrimeve nga bankat e tjera barten në KA kur: (i) ato mbahen për qëllim të grumbullimit të rrjedhave të parave kontraktuale dhe ato rrjedha të parave përfaqësojnë VPKI dhe (ii) nuk përcaktohen në VDPFH.

Investimet në letrat me vlerë të borxhit

Bazuar në modelin e biznesit dhe karakteristikat e rrjedhës së parasë, Banka i klasifikon investimet në letrat me vlerë të borxhit si të bartura në KA, VDATGj ose VDPFH. Ato barten në KA nëse mbahen për mbledhjen e rrjedhës së parave kontraktuale dhe kur ato rrjedha parash përfaqësojnë VPKI, dhe nëse nuk janë përcaktuar vullnetarisht në VDPFH në mënyrë që të zvogëlohet ndjeshëm mospërputhja kontabël.

Letrat me vlerë të borxhit barten në VDATGj nëse ato mbahen për grumbullimin e rrjedhave të parave kontraktuale dhe për shitje, ku ato rrjedha të parave përfaqësojnë VPKI dhe nuk përcaktohen në VDPFH. Të ardhurat e interesit llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihen në fitim ose humbje.

Një rezervë për zhvlerësim të kredive i matur duke përdorur modelin e humbjeve të pritura kreditore njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin. Të gjitha ndryshimet e tjera në shumën bartëse njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ). Kur investimet në letra me vlerë çregjistrohen, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në ATGJ riklasifikohet nga ATGJ në fitim ose humbje.

Investimet në letrat me vlerë të borxhit barten në VDPFH nëse ato nuk i plotësojnë kriteret për tu mbajtur në KA ose VDATGj. Banka mund t'i përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme investimet në letrat me vlerë të borxhit në VDPFH në njohjen fillestare nëse zbatimi i këtij opsiioni e zvogëlon ndjeshëm një mospërputhje kontabël ndërmjet pasurive dhe detyrimeve që njihen ose maten në baza të ndryshme të kontabilitetit.

Kredi dhe paradhënie për klientë

Kreditë dhe paradhëniet për klientët regjistrohen kur Banka jep para për të blerë ose origjinuar një kredi që i takon një klienti. Bazuar në modelin e biznesit dhe karakteristikat e rrjedhave të parave, Banka klasifikon kreditë dhe paradhëniet për klientët në njërin nga kategoritë e mëposhtme të matjes: (i) KA: Kreditë që mbahen për grumbullimin e rrjedhave të parave kontraktuale dhe ato rrjedha të parave përfaqësojnë SPPI dhe kreditë që nuk janë të përcaktuar vullnetarisht në VDPFH dhe (ii) VDPFH: kreditë që nuk e përmbushin testin VPKI ose kriteret e tjera për KA ose VDATGj maten në VDPFH.

Kolaterali i riposeduar

Kolaterali i riposeduar përfaqëson pasuritë jofinanciare të përfituara nga Banka si pagesë e kredive të papaguara. Pasuritë fillimisht njihen në vlerën e drejtë kur të blihen dhe përfshihen në pasuritë e riposeduara brenda pasurive të tjera. Më pas, Banka mat kolateralin e riposeduar në vlerën më të ulët ndërmjet kostos (shuma e njohur fillimisht) dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje. Kolaterali i riposeduar shlyhet në rast se nuk shitet nga Banka brenda 5 viteve nga riposedimi bazuar në rregulloren e bankës qendrore.

2 PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Kolaterali i riposeduar (vazhdim)

Pasuria e luajtshme nuk njihet si pasuri kur riposedohet. Humbjet që rrjedhin nga ri-matja e mësipërme regjistrohen në fitim ose humbje dhe mund të rikuperohen në të ardhmen. Fitimet ose humbjet nga shitja e këtyre pasurive njihen në fitim ose humbje.

Garancionet financiare

Garancionet financiare kërkojnë që Banka të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që lind sepse një debitor specifik nuk arrin të bëjë pagesën në kohën e duhur në përputhje me afatet fillestare ose të modifikuara të një instrumenti borxhi. Garancionet financiare fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të pranuara. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare gjatë jetës së garancisë. Në fund të secilës periudhë raportuese, garancionet maten në shumën më të lartë ndërmjet (i) shumës së provizionit për humbje kreditore për ekspozimin e garantuar të përcaktuar bazuar në modelin humbjeve të pritshme kreditore dhe (ii) bilanci i mbetur i paamortizuar i shumës në njohjen fillestare. Përveç kësaj, rezerva për HPK njihet për tarifën e arkëtueshme që njihen në pasqyrën e pozitës financiare si pasuri.

Zotimet e lidhura me kreditë

Banka lëshon garanci financiare dhe zotime për të dhënë kredi. Këto zotime fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, gjë që normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të pranuara. Kjo shumë amortizohet në bazë lineare gjatë jetës së zotimit, me përjashtim të zotimeve ndaj kredive origjinale, nëse është e mundshme që banka do të hyjë në një marrëveshje specifike kreditimi dhe nuk pret të shesë kredinë që rezulton menjëherë pas fillimit; tarifën për zotimet e tilla shtyhen dhe përfshihen në vlerën bartëse të kredisë në njohjen fillestare. Në fund të çdo periudhë raportuese, zotimet maten në (i) bilancin e mbetur të paamortizuar të shumës në njohjen fillestare, plus (ii) shumën e provizionit për zhvlerësim kreditor të përcaktuar në bazë të modelit të humbjeve të pritshme kreditore, përveç nëse zotimi është për të siguruar një kredi me një normë interesi më të ulët se norma e tregut, me ç'rast matja bëhet në shumën më të lartë mes këtyre dy shumave. Shuma bartëse e zotimeve të kredisë regjistrohet si një detyrim. Për kontratat që përfshijnë edhe kredi edhe zotim të patërhequr dhe kur Banka nuk mund ta dallojë ndaras HPK në komponentin e pjesës së pashfrytëzuar nga komponenti i kredisë, HPK për zotimin e pashfrytëzuar njihet së bashku me rezervën për humbje kreditore. Për atë që HPK-të e kombinuara e tejkalojnë shumën bartëse bruto të kredisë, ato njihen si detyrim.

Pronat investive

Prona investive është pronë e mbajtur nga Banka për të fituar të ardhura nga qiraja ose për rritjen e vlerës së kapitalit, ose të dyja dhe e cila nuk është në përdorim nga Banka.

Prona investive fillimisht njihet sipas kostos, përfshirë kostot e transaksionit, dhe më pas ri-matet me vlerën e drejtë të azhurnuar për t'i pasqyruar kushtet e tregut në fund të periudhës së raportimit.

Vlera e drejtë e pronës së investimit është çmimi që do të merrej nga shitja e pasurisë në një transaksion të rregullt, pa zbritje të ndonjë kostoje të transaksionit.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë jepet nga çmimet aktuale në një treg aktiv për prona të ngjashme në të njëjtin vendndodhje dhe gjendje. Çdo rritje që rezulton në shumën bartëse të pronës njihet në fitim ose humbje, përveç nëse lidhet me një transferim nga prona e zotëruar nga pronari në pronë të investimit, në të cilin rast rritja njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Çdo ulje e shumës bartëse fillimisht mbulohet nga teprica e rivlerësimit e njohur më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, nëse ka, me ndonjë ulje të mbetur të ngarkuar në fitim ose humbje për vitin.

2 PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Pronat investive (vazhdim)

Në mungesë të çmimeve aktuale në një treg aktiv, Banka shqyrton informacione nga burime të ndryshme, duke përfshirë:

- çmimet aktuale në një treg aktiv për pronat me një natyrë, gjendje ose vendndodhje tjetër, të korrigjuara për t'i pasqyruar ato dallime;
- çmimet e fundit të pronave të ngjashme në tregjet më pak aktive, me korrigjime për t'i pasqyruar dallimet në kushtet ekonomike që nga data e transaksioneve që kanë ndodhur me ato çmime; dhe
- parashikimet e rrjedhave të skontuara të parasë bazuar në vlerësime të besueshme të rrjedhave të ardhshme të parasë nga dëshmi të jashtme, siç janë çmimet aktuale të tregut për prona të ngjashme në të njëjtën zonë dhe kushte, dhe duke përdorur normat e skontimit që pasqyrojnë vlerësimet aktuale të tregut të pasigurisë së shumës dhe kohës së rrjedhave të parave.

Vlera e drejtë e pronës së investimit të Bankës përcaktohet në bazë të raportit të vlerësuesve të pavarur, të cilët kanë kualifikim profesional të njohur dhe relevant dhe që kanë përvojë të fundit në vlerësimin e pronave me vendndodhje dhe kategori të ngjashme.

Pronat dhe pajisjet

Pronat dhe pajisjet paraqiten në kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbja e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse kërkohet. Kostoja historike përfshin shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së artikujve të pronës dhe pajisjeve.

Shpenzimet pasuese përfshihen në shumën bartëse të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të vijnë në Bankë dhe kostoja e zërit mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera i ngarkohen shpenzimeve tjera operative gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Çdo vit, Banka vlerëson nëse ka tregues se pasuritë mund të jenë zhvlerësuar. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet shuma e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e vlerësuar është shuma më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë të pasurisë minus kostot e shitjes dhe vlerës së saj në përdorim. Kur shuma bartëse e një pasurie është më e madhe se shuma e rikuperueshme e vlerësuar e saj, ajo ulet në shumën e saj të rikuperueshme dhe diferenca i ngarkohet fitimit ose humbjes.

Fitimet dhe humbjet me shitjen e pronës dhe pajisjeve përcaktohen duke iu referuar shumës bartëse të tyre dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për atë periudhë.

Toka dhe ndërtimet në vazhdim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi për zërat e tjerë të pronës dhe pajisjeve njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare për të alokuar koston e tyre gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Normat vjetore të amortizimit përcaktohen nga jetëgjatësia e vlerësuar e pasurive të caktuara siç janë paraqitur më poshtë:

Kategoria e pasurive	Normat e përdorura të zhvlerësimit
Përmirësimet e hapësirave të marra me qira	Koha më e shkurtër ndërmjet jetëgjatësisë dhe kohëzgjatjes së qirasë përkatëse
Mobile, instalime dhe pajisje	3-5 vite
Kompjuterët dhe pajisjet përcjellëse	3-5 vite
Automjetet motorike	5 vite

Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme njihen nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen pasurisë do të hyjnë në Bankë dhe kostoja e pasurisë mund të matet me besueshmëri. Pasuritë e paprekshme fillimisht maten në kosto dhe më pas në kosto minus amortizimi i akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi i akumuluar. Vlerat bartëse të pasurive të paprekshme rishikohen për rënie në vlerë, kur ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera bartëse nuk mund të realizohet. Pasuritë e paprekshme përbëhen tërësisht nga programet kompjuterike dhe licencat, që amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar deri në pesë vjet. Të gjitha kostot e tjera që lidhen me programet kompjuterike, p.sh. mirëmbajtja, shpenzohen kur ndodhin.

2 PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Pasuritë me të drejtë përdorimi

Në fillimin e një kontrate, Banka vlerëson nëse kontrata është ose përmban lizing. Një kontratë është, ose përmban, lizing nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një pasurie të identifikuar për një periudhë kohore në këmbim të shumës.

Banka që vepron si qiramarrëse

Banka merr me qira zyra të ndryshme për degët, bankomatët dhe zyrën e saj qendrore. Kontratat mund të përmbajnë komponentë të qirasë dhe jo-të qirasë. Banka i ndan pagesat në kontratë komponentëve të qirasë dhe atyre jo të qirasë bazuar në çmimet e tyre relative të pavarura.

Pasuritë me të drejtë përdorimi maten në kosto që përfshin të mëposhtmet:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë,
- çdo pagesë të qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, minus çdo stimulim i pranuar i qirasë,
- çdo kosto fillestare direkte, dhe
- kostot për kthimin e pasurisë në kushtet e kërkuara nga marrëveshjet e qirasë.

Pasuritë me të drejtë përdorimi në përgjithësi amortizohen gjatë jetëgjatësisë së pasurisë ose afatit të qirasë, cilado që është më e shkurtër, në bazë lineare. Nëse Banka është mjaft e sigurt për ta ushtruar një opsion të blerjes, pasuria me të drejtë përdorimi amortizohet gjatë jetëgjatësisë së pasurive themelore. Amortizimi për zërat e pasurive me të drejtë përdorimi llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar.

Zhvlerësimi i pasurive jo financiare

Një humbje nga zhvlerësimi regjistrohet atëherë kur vlera bartëse e një pasurie tejkalon shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e një pasurie është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorim e një pasurie është vlera e tanishme e rrjedhave të vlerësuara të parasë në të ardhmen të pritura nga përdorimi i vazhdueshëm i një pasurie dhe nga shitja e saj.

Detyrimet ndaj bankave të tjera dhe llogarive të klientëve

Detyrimet ndaj bankave të tjera: Detyrimet ndaj bankave të tjera regjistrohen kur paratë ose pasuritë e tjera i janë dhënë Bankës nga bankat e tjera. Detyrimi jo-derivativ bartet në kosto të amortizuar. Nëse Banka blen borxhin e vet, atëherë detyrimi hiqet nga pasqyrat e pozitës financiare, diferenca midis shumës bartëse të detyrimit dhe shumës së paguar përfshihet në fitimet ose humbjet që rrjedhin nga shlyerja e borxhit.

Llogaritë e klientëve: Llogaritë e klientëve janë detyrime jo-derivative ndaj individëve, shtetit ose korporatave dhe mbahen me kosto të amortizuar.

Tatimi

Tatimi në të ardhura përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Njihet në fitim ose humbje me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur drejtpërdrejt në Ekuitet ose në të Ardhurat e Tjera Gjithëpërfshirëse.

Tatimi në të ardhura

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen e vitit dhe korrigjimet e tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Ai matet duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet shumave bartëse të pasurive dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të pasurive ose detyrimeve në një transaksion që nuk është kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as në kontabilitet, as në fitimin ose humbjen e tatueshme.

Pasuritë tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të pashfrytëzuara, kreditimet tatimore të pashfrytëzuara dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që fitime të tatueshme të ardhshme të jenë në dispozicion kundrejt të cilave ato mund të përdoren.

2 PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Tatimi i shtyrë (vazhdim)

Pasuritë tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen nëse nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen. Tatimi i shtyrë matet në norma tatimore që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat tatimore që janë miratuar ose që në mënyrë thelbësore janë miratuar në datën e raportimit.

Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjërish për të kompensuar detyrimet dhe pasuritë tatimore aktuale, dhe ato lidhen me tatimet e vendosura nga i njëjti autoritet tatimor në të njëjtin entitet të tatueshëm.

Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka e merr parasysh ndikimin e ekspozimeve tatimore, duke përfshirë mundësinë e pagesës së tatimeve shtesë dhe interesit. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme.

Informacion i ri mund të vihet në dispozicion dhe bën që Banka ta ndryshojë vendimin e saj në lidhje me adekuatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikonin në detyrimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim të tillë.

Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat

Provizionet për detyrimet dhe ngarkesat janë detyrime jofinanciare me kohë ose shuma të pasigurta, të regjistruara kur Banka ka një obligim ligjor ose konstruktiv nga ngjarje të kaluara dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Ato llogariten bazuar në vlerësimin më të mirë të menaxhmentit dhe zbriten në vlerën e tanishme kur efekti është material.

Tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat e korporatave ose tarifave rregullative të bazuara në informacionet që kanë të bëjnë me një periudhë para lindjes së detyrimit për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja obliguese që shkakton pagesën e detyrimit, siç përcaktohet nga legjislacioni në të cilin përcaktohet obligimi për të paguar detyrimin. Nëse një pagesë kryhet para ngjarjes detyruese, ajo njihet si parapagim.

Detyrimet e qirasë

Detyrimet që rrjedhin nga qiraja fillimisht maten në bazë të vlerës së tashme. Detyrimet e qirasë përfshijnë vlerën e tashme neto të pagesave të mëposhtme të qirasë:

- pagesa fikse (përfshirë pagesa fikse në substancë), minus çdo stimulim të pranueshëm të qirasë.
- shumat që pritet të paguhën nga qiramarrësi nën garancitë e vlerës së mbetur.
- çmimi i ushtrimit të një opsioni të blerjes nëse qiramarrësi është mjaft i sigurt se do ta ushtrojë atë mundësi, dhe
- pagesa e gjobave për ndërprerjen e qirasë, nëse afati i tij pasqyron se qiramarrësi e ushtron atë mundësi.

Pagesat e qirasë skontohe duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet, përdoret norma inkrementale e huamarrjes e qiramarrësit, që është norma që qiramarrësi do të duhej ta paguante për t'i marrë hua fondet e nevojshme për ta marrë një pasuri të një vlere të ngjashme në një mjedis të ngjashëm ekonomik me kushte dhe afate të ngjashme.

Për ta përcaktuar shkallën e inkrementale të huamarrjes, Banka përdor normat inkrementale të huamarrjes, të llogaritura nga Departamenti i Thesarit.

Banka është e ekspozuar ndaj rritjeve të mundshme në të ardhmen të pagesave të ndryshueshme të qirasë bazuar në një indeks ose normë, të cilat nuk përfshihen në detyrimin e qirasë deri sa të hyjnë në fuqi. Kur korrigjimet në pagesa të qirasë bazuar në një indeks ose normë hyjnë në fuqi, detyrimi i qirasë rivlerësohet dhe korrigjohet kundrejt pasurisë me të drejtë përdorimi.

Pagesat e qirasë ndahen ndërmjet kostove të kryegjësë dhe financiare. Kostot financiare ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë të vazhdueshme periodike të interesit në pjesën e mbetur të detyrimit për secilën periudhë.

Pagesat e shoqëruara me qiramarrje afatshkurtër të pajisjeve dhe automjeteve dhe të gjitha qiramarrjet e pasurive me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si shpenzim në fitim ose humbje. Qiratë afatshkurtra janë qiratë me afat 12 muaj ose më pak.

2 PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Përfitimet e punonjësve

Banka paguan kontributet për planin pensional të administruar publikisht Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës të cilat janë të detyrueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi që të jenë paguar kontributet. Kontributet njihen si shpenzim i përfitimëve të punonjësve në kohën kur ato duhet të paguhen.

Të pagueshmet dhe të tjera të pagueshme

Të pagueshmet përlllogariten, kur pala tjetër ka kryer obligimet përkatëse sipas kontratës dhe mbahen me koston e amortizuar.

Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si ekuitet. Kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejtë emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në ekuitet si zbritje, neto nga tatimi. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara shënohet si prim për aksion në ekuitet.

Dividendët

Dividendët regjistrohen në ekuitet në periudhën në të cilën janë deklaruar nga aksionarët e Bankës dhe janë miratuar nga BQK-ja në përputhje me rregulloren e BQK-së në fuqi. Çdo dividend i deklaruar pas përfundimit të periudhës raportuese dhe para se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, shpaloset në shënimet e ngjarjeve pasuese.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi regjistrohen për të gjitha instrumentet financiare të matura në KA, mbi bazën akruale, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kjo metodë shtyn, si pjesë e të ardhurave ose shpenzimeve nga interesi, të gjitha tarifat e paguara ose të marra midis palëve të kontratës që janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv, kostove të transaksionit dhe të gjitha primeve ose zbritjeve të tjera.

Tarifat të cilat janë pjesë përbërëse të normës efektive të interesit përfshijnë tarifat fillestare të pranuar ose të paguara nga Banka, lidhur me krijimin ose blerjen e pasurive financiare ose lëshimin e detyrimeve financiare, për shembull, tarifat për vlerësimin e aftësisë për kthimin e kredisë, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive ose kolateralit, negocimin e afateve të instrumenteve dhe tarifat për procesimin e dokumentacionit të transaksionit. Tarifat e zotimit të pranuar nga Banka për të krijuar kredi me normat e interesit të tregut janë përbërëse në normën efektive të interesit nëse është e mundshme se Banka do të hyjë në një marrëveshje specifike të huadhënies dhe nuk pret që ta shesë kredinë që rezulton menjëherë pas krijimit. Banka nuk i përcakton zotimet kreditore si detyrime financiare në VDPFH.

Për pasuritë financiare të cilat janë zhvlerësuar në blerje ose krijim, norma efektive e interesit është norma që i skonton rrjedhat e pritura të parasë (përfshirë humbjet fillestare të pritura të kredive) deri në vlerën e drejtë të njohjes fillestare (normalisht e përfaqësuar nga çmimi i blerjes minus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt). Si rezultat, norma efektive e interesit korrigjohet sipas kredisë.

Të ardhurat nga interesi llogariten duke përdorur normën efektive të interesit në shumën bartëse bruto të pasurive financiare, përveç (i) pasuritë financiare ku krediti është zhvlerësuar (Faza 3), për të cilat të ardhurat nga interesi llogariten duke përdorur normën efektive të interesit në ato KA, neto nga provizioni i HPK dhe (ii) pasuritë financiare të zhvlerësuar nga blerja ose fillimi, për të cilat norma fillestare efektive e interesit e rregulluar sipas kredisë përdoret në KA.

Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet njihen si më poshtë:

Tarifat e marra që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit të një instrumenti financiar (tarifat fillestare siç janë tarifat për vlerësimin e aftësisë kreditore, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive ose kolateralit, negocimin e afateve të instrumentit dhe për përpunimin e dokumenteve të transaksionit, etj.) amortizohen sipas metodës së normës efektive të interesit gjatë jetës efektive të kontratave.

2 PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE TË POLITIKAVE MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Tarifat dhe komisionet (vazhdon)

Tarifat për të cilat detyrimi i përmbushjes përmbushet në një moment kohor - këto tarifa njihen si të ardhura ose shpenzime kur përmbushet detyrimi i përmbushjes (zakonisht kur ekzekutohet shërbimi). Tarifa dhe komisione të tilla përfshijnë tarifa nga (për): pagesa ndërkombëtare, pagesa të brendshme, SMS banking, tarifa të kartelave të kreditit (komisione të tregtarëve, tarifa nga klientë të bankave të tjera që përdorin терминалет e POS dhe bankomatëve të Bankës, tarifat VISA dhe Master etj.), tarifa të shërbimeve të llogarisë (tarifa e tërheqjes së parave, tarifa e deponimit të parave, tarifat e rivendosjes së pinit, dhe të mbylljes së llogarisë), tarifat nga transferet e parave, etj.

Tarifat për të cilat detyrimi i përmbushjes përmbushet me kalimin e kohës - këto tarifa njihen si të ardhura ose shpenzime kur detyrimi i përmbushjes përmbushet me kalimin e kohës (regjistruar përgjithësisht në bazë akruale duke iu referuar përfundimit të transaksionit specifik të vlerësuar në bazë të shërbimit real të ofruar si proporcion i shërbimeve totale që ofrohen). Tarifa të tilla përfshijnë tarifat e mirëmbajtjes së kartelës së kreditit dhe llogarisë, tarifat për garancitë dhe letërkreditë, etj.

Konvertimet e valutës së huaj

Valuta funksionale e Bankës është valuta e mjedisit primar ekonomik në Republikën e Kosovës.

Pasuritë dhe detyrimet monetare në valuta të tjera përkthehen në valutën funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të BQK-së në fund të periudhës raportuese përkatëse. Fitimet dhe humbjet valutores që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i pasurive dhe detyrimeve monetare në valutën funksionale me kurset zyrtare të këmbimit të BQK-së në fund të vitit, njihen në fitim ose humbje për vitin (si fitimet minus humbjet nga këmbimi valutor). Përkthimi në fund të vitit nuk aplikohet për artikujt jo-monetarë që maten me kosto historike.

Zërat jo-monetarë të matura me vlerën e drejtë në një valutë të huaj, janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në zërat jo-monetarë të matura me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj regjistrohen si pjesë e fitimit ose humbjes në vlerën e drejtë.

Kompensimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozitës financiare vetëm atëherë kur ka të drejtë ligjore të zbatueshme për t'i kompensuar shumat dhe banka synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto, ose ta realizojë pasurinë dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht. E drejta e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) rastet e mospagimit dhe (iii) rastet e mungesës së aftësisë paguese ose falimentimit.

3 VLERËSIMET KRITIKE DHE GJYKIMET NË ZBATIMIN E POLITIKAVE TË KONTABILITETIT

Banka bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në shumat e raportuara në pasqyrat financiare, dhe shumat bartëse të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e menaxhmentit dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme bazuar në rrethanat e caktuara. Menaxhmenti gjithashtu kryen gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë korrigjim domethënës në shumën bartëse të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Matja e humbjeve të pritura kreditore (HPK). Matja e humbjeve të pritura kreditore (HPK) është një vlerësim i rëndësishëm që përfshin përcaktimin e metodologjisë, modeleve dhe inputeve të të dhënave. Detajet e metodologjisë së matjes së HPK janë shpalosur në Shënimin 33. Komponentët e mëposhtëm kanë ndikim madhor në llogaritjen e rezervës për humbjet kreditore: përkufizimi i mospagesës, kriteret për RrKRrK, PM, EnM dhe HpMP, si dhe modelet e skenarëve makroekonomikë. Banka bazuar në Politikën e Zhvlerësimit të publikuar të SNRF 9 rregullisht rishikon dhe validon modelet dhe inputet për të zvogëluar çdo dallim ndërmjet vlerësimeve të pritshme të humbjeve kreditore dhe përvojës aktuale të këtyre humbjeve.

Duke filluar nga qershori 2023, banka filloi përllogaritjet e HPK-së bazuar në metodologjinë e sapovaliduar. Parametrat EnM, PM dhe HpMP të HPK-së u përditësuan bazuar në të dhënat e fundit sipas kërkesave të modelit. Në metodologjinë e re të HPK-së, informacioni i parashikimit integrohet duke marrë parasysh treguesit dhe skenarët makroekonomikë. Për Modelin Makroekonomik Tregtar përdoren tregues të tillë si BPV, IÇK, Remitancat Vjetore dhe treguesit e rritjes së kredisë. Si rezultat i testit të korrelacionit, BPV është i vetmi variabël i rëndësishëm për modelin e bazuar në historikun e mospagimit të bankës. Për modelin makroekonomik retail, treguesit Remitanca Vjetore dhe IÇK janë të rëndësishme në model.

Sipas IFRS 9, Banka përfshin informacion të parashikuar në vlerësimin e Humbjes së pritur nga kreditë (HPK) duke përdorur një qasje të skenarëve diskretë. Tre skenarë janë zhvilluar—skenari bazë, i mirë dhe i keq—skenari bazë rrjedh nga parashikimet makroekonomike të FMN-së. Peshat e probabilitetit për secilin skenar bazohen në frekuencën historike të episodeve të ngjashme ekonomike, të rishikuara të paktën një herë në vit. Analiza e regresionit, e kryer në softuerin R, modelon marrëdhënien midis PBB-së (i identifikuar si faktori kryesor makroekonomik) dhe pikes kohore të probabilitetit të dështimit për portofolat e kredive për biznes dhe retail.

Testet e zgjeruara statistikore sigurojnë qëndrueshmërinë e modelit dhe PM-ja mesatare e ponderuar që rezulton përdoret për të llogaritur HPK-në, duke reflektuar dinamikën e rrezikut të kredisë jo-lineare. Këto teste, përfshirë kontrollin për (i) stacionaritetin, (ii) autokorrelacionin dhe (iii) heteroskedasticitetin, vërtetojnë besueshmërinë e modelit të regresionit që lidh PBB-në me PM-në. PM-ja mesatare e ponderuar, e nxjerrë nga skenarët me peshë probabiliteti, kap ndikimin disproporcional të kushteve të pafavorshme ekonomike, duke siguruar përputhshmëri me kërkesat e IFRS 9 për informacion të parashikuar.”

Në vitin 2023, llogaritja HPK e metodologjisë ndryshoi nga një përjasje e thjeshtuar e cila nuk përfshinte informacione parashikuese, në një përjasje më të avancuar të llogaritjes së HPM-së. Në metodologjinë e HPK-së, informacioni i parashikimit integrohet duke marrë parasysh treguesit dhe skenarët makroekonomikë. Zbatohen treguesit makroekonomikë të përcaktuar për parashikimin 3-vjeçar.

Treguesit e BPV, IÇK, Remitancave Vjetore, Rritjes së kredive përdoren në modelin makroekonomik për portofolin komercial. Si rezultat i testit të korrelacionit, BPV është i vetmi variabël i rëndësishëm për modelin e bazuar në historikun e mospagimit të Bankës.

Treguesit e BPV, IÇK, Remitancave Vjetore, Rritjes së kredive përdoren në modelin makroekonomik për portofolin retail. Variablat e remitancave dhe IÇK-së (mesatarisht 6 muaj) janë të rëndësishme në model.

Skenari bazë përbën rezultatin më të mundshëm që rezulton nga procesi normal i buxhetimit të Bankës, ndërsa skenarët më të mirë dhe më të keq përbëjnë rezultate më optimiste ose pesimiste.

3 VLERËSIMET KRITIKE DHE GJYKIMET NË ZBATIMIN E POLITIKAVE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Matja e humbjeve të pritura kreditore (HPK)-(vazhdim)

Në fund të dhjetorit 2024, Banka vazhdoi të aplikonte një provizion shtesë për humbjen e pritshme të kreditore (HPK) të përlogaritur në vlerën 828 mijë euro (2023: 1 milion euro). Ky provizion shërben si një faktor shtesë për klientët dhe sektorët në Ndërtimtari dhe Materiale Tregtare, si dhe për rastet e vlerësuara individualisht të vlerësuara nga KLVD dhe Komiteti i Provizionit. Sipas vlerësimit të menaxhmentit, ECL e regjistruar pas aplikimit të faktorëve shtesë është e përshtatshme.

Duke marrë parasysh procesin e liberalizimit të vizave duke filluar nga janari i vitit 2024, TEB SH.A. ka kryer një analizë të ndjeshmërisë për pjesën e pasiguar të portofolit retail. Është vlerësuar se 3.6% e këtij portofoli do të pësonte vonesa më shumë se 30 ditë, duke rezultuar në zhvendosjen e këtyre pasurive në Fazën 2, me një normë provizionimi prej 7.76%.

Si rezultat i analizës për rezultatet e HPK-së në dhjetor 2023, menaxhmenti i Bankës vendosi për një mbivendosje të provizionit shtesë për Fazën 1, në shumë prej 712 mijë euro. Banka vendosi të mbajë të njëjtën shumë provizion në fund të dhjetorit 2024. Rreziku i mundshëm i përkeqësimit të kredisë do të monitorohet vazhdimisht nga Banka dhe shuma e mbivendosur do të rivlerësohet gjatë vitit.

Ekspozimi kreditor në mundësitë kreditore revolvuese (p.sh. kartelat e kreditit, mbitërheqjet). Për këto pasuri, Banka aplikon një afat maturimi 12-mujor dhe përdor HPK. Bazuar në procedurat e brendshme të Bankës, këto produkte vlerësohen në baza vjetore pas një vlerësimi të shëndoshë të rrezikut kreditor dhe këto limite janë të revokueshme nga ana ligjore dhe Banka mund të anulojë zotimin në çdo kohë.

Rritja e konsiderueshme e rrezikut kreditor ("RRKRrK"). Për ta përcaktuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor, përveç minimum 30 ditë në vonesë (DNV) që përdoret si kriter, Banka do të përdorë kritere të tjera cilësore parashikuese, të përkufizuara nga Banka për ta përcaktuar se çfarë duhet të konsiderohet si rritje e konsiderueshme e rrezikut kreditor dhe kështu e krahason jetëgjatësinë relative ndërmjet rrezikut të mospagesës në çdo datë të vëzhgimit me mospagesën përgjatë jetëgjatësisë nga data e fillimit. Krahas kritereve cilësore *backstop*, Banka ka kritere 'Nuk ka gjasa të paguajë' (UTP) siç janë shpalosur në Politikën e Zhvlerësimit sipas SNRF9, të cilat përdoren si një instrument tjetër për matjen e RrKRrK-së për portofolin retail dhe atë tregtar. Nëse RrKRrK identifikohet që nga njohja fillestare, instrumenti financiar kalon në Fazën 2, por nuk konsiderohet ende i zhvlerësuar dhe rezerva e humbjes bazohet në PM-të e jetëgjatësisë.

Kreditë me afate të rinegociuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe ku banka ka bërë lëshime të cilat nuk do të konsideronte përndryshe. Vendim për ristrukturim i nënshtrohet parakushteve vijuese:

- ristrukturimi rrit probabilitetin që huamarrësi të jetë në gjendje ta paguajë ekspozimin.
- plani i ri i pagesave është në harmoni me kapacitetin aktual dhe të pritur të huamarrësit për pagesë në të ardhmen.
- huamarrësi ofron kolateral shtesë, nëse është e mundshme dhe e përshtatshme.

Kreditë me afate të rinegociuara

	2024	2023
Faza 1	223	287
Faza 2	1,129	1,178
Faza 3	628	995
Shuma totale bruto	1,980	2,460
Zhvlerësimi individual	(459)	(618)
Zhvlerësimi kolektiv	(177)	(394)
Kreditë neto me afate të rinegociuara	1,344	1,448

8 KREDI DHE PARADHËNIE PËR KLIENTË (VAZHDIM)

Përqendrimi i rrezikut të sektorit ekonomik në portfolion e kredive për klientë është si në vijim:

	31 dhjetor 2024		31 dhjetor 2023	
	Kreditë neto	%	Kreditë neto	%
Individët	354,355	49.3%	309,213	51.70%
Rrymë, gaz, ujë	3,977	0.6%	1,046	0.17%
Industria	74,933	10.4%	53,159	8.89%
Bujqësia	12,142	1.7%	10,874	1.82%
Shërbimet dhe të tjera	29,971	4.2%	22,907	3.83%
Hotelet dhe restorantet	17,436	2.4%	12,290	2.05%
Transporti dhe komunikimet	12,696	1.8%	9,348	1.56%
Ndërtimtaria	28,766	4.0%	24,370	4.07%
Tregtia	184,731	25.7%	154,872	25.89%
Kreditë neto për klientët	719,007	100.0%	598,079	100.0%

Llojet e kolateralit

Politikat e Bankës në lidhje me marrjen e kolateralit nuk kanë ndryshuar në krahasim me politikën e vitit të kaluar.

Vlera e drejtë e kolateralit e shpalosur më poshtë përcaktohet nga vlerësues të certifikuar vendorë të brendshëm dhe të jashtëm të Bankës dhe ka për qëllim ta përfaqësojë vlerën e tregut të realizueshme nga pronarët ligjorë të pasurive. Për shkak të rrethanave vendore në Kosovë ku tregu nuk është aktiv, Banka kërkon ta miratojë një qasje të kujdesshme në përcaktimin e vlerës së kolateraleve të tilla. Banka synon të përdorë kolaterale që mund të konvertohen në pasuri likuide brenda një periudhe të shkurtër kohore.

	2024			2023		
	Individët	Korporatë	Gjithsej	Individë	Korporatë	Gjithsej
Hipotekë	75,825	417,223	493,048	65,818	362,919	428,737
Kolateral në para të gatshme	2,133	4,008	6,141	2,479	3,957	6,436
Mallrat dhe pajisjet e lëna peng	57,776	644,006	701,782	75,350	558,162	633,512
Veturat e lëna peng	30,326	84,907	115,233	22,305	66,021	88,326
Gjithsej	166,060	1,150,144	1,316,204	165,952	991,059	1,157,011

Efekti financiar i kolateralit paraqitet duke shpalosur vlerat e kolateralit veçmas për (i) ato pasuri ku kolaterali dhe siguritë e tjera të kredisë janë të barabarta ose tejkalojnë vlerën bartëse të pasurisë ("pasuri të tej-kolateralizuara") dhe (ii) ato pasuri ku kolaterali dhe siguritë e tjera të kredisë janë më pak se vlera bartëse e pasurisë ("pasuritë e nën-kolateralizuara"). Efekti i kolateralit më 31 dhjetor 2024:

	Kolateral i tepërt Pasuritë		Kolateral i mangët Pasuritë		Asetet pa Kolateral
	Vlera bruto e kredive	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera bruto e kredive	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera bruto e krediv
Kreditë për individë	68,305	157,454	61,753	8,606	230,911
Kreditë për persona juridikë	321,165	1,130,904	28,728	19,241	19,174
Gjithsej	389,470	1,288,358	90,481	27,847	250,085

Kreditë individuale të papa kolateral ipen kryesisht për klientët që kanë llogarinë e pagës ose të punës me bankën

8 KREDI DHE PARADHËNIE PËR KLIENTË (VAZHDIM)

Efekti i kolateralit më 31 dhjetor 2023:

	Pasuritë e mbi-kolateralizuara		Pasuritë e nën-kolateralizuara		Asetet pa Kolateral
	Vlera bruto e kredive	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera bruto e kredive	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera bruto e kredive
Kreditë për individë	66,026	160,525	48,847	5,427	199,350
Kreditë për persona juridikë	267,099	978,427	19,294	12,634	7,904
Gjithsej	333,125	1,138,952	68,141	18,061	207,254

Shumat e papaguara kontraktuale të kredive dhe paradhënies për klientët që janë shlyer që janë ende subjekt i veprimtarisë së përmbarimit, ishin si vijon më 31 dhjetor 2024 dhe 2023:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
<i>Kreditë për klientët korporata</i>	9,022	9,200
Kreditë	6,797	7,018
Mbitërheqje	1,428	1,397
Kredit kartela	797	785
<i>Kreditë për individë</i>	4,799	4,209
Kreditë	2,715	2,266
Mbitërheqje	238	207
Kredit kartela	1,846	1,736
Gjithsej	13,821	13,409

9 PRONAT INVESTIVE

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Pronat e investimeve në vlerë të drejtë më 1 janar	2,035	1,920
Rritja në vlerën e drejtë nga vlerësimi	45	115
Pronat e investimeve në vlerë të drejtë më 31 dhjetor	2,080	2,035

Prona investive e bankës përfshin një tokë ndërtimore të transferuar nga prona e banuar nga pronari në pronë investimi të mbajtur për rritje të vlerës së kapitalit. Toka është blerë në vitin 2013 me qëllim që të shfrytëzohet për ta ndërtuar zyrën qendrore të Bankës. Më 20 maj 2019, Komiteti Ekzekutiv i bankës mori vendim për ta braktisur planin e kompleksit të zyrës qendrore në favor të zgjidhjes aktuale të qirasë afatgjatë. Ky vendim pati si rezultat transferin e pasurisë në pronë të investimeve. Banka zgjedh të masë pronën e investimit me vlerën e drejtë.

Matja e vlerës së drejtë

Matja e pronës investive klasifikohet në nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë pasi inputet dhe supozimet e përdorura për të arritur në vlerën e drejtë janë të pa vëzhgueshme. Në mungesë të tregut aktivë, vlera e drejtë e pronës së investimit më 31 dhjetor 2024 u përcaktua duke përdorur Metodën e krahasimit të shitjeve dhe Metodën e mbetjes.

9 PRONAT INVESTIVE (VAZHDIM)

Teknikat e vlerësimit	Përshkrimi i teknikës së vlerësimit
Metoda e krahasimit	Metoda e krahasimit direkt bazohet në krahasimin e çmimeve për prona të ngjashme në të njëjtin treg me një distancë rreth 500m. Çmimet e krahasueshme të shitjes janë rregulluar, kur është e përshtatshme, duke marrë parasysh indekset për planet rregulluese, vendndodhjen e pronës dhe qasjen dhe infrastrukturën. Çmimi mesatar për m ² bazuar në krahasimin e çmimit të kërkesës me kushte të ngjashme, u rregullua me faktorin e ofertës minus -10%/20%.
Metoda e mbetjes	Metoda e mbetjes vlerëson vlerën e pronës duke përcaktuar vlerën e saj të mundshme pas zhvillimit. Ajo përfshin llogaritjen e vlerës së tregut duke zbritur kostot e zhvillimit ose rindërtimit dhe fitimin e zhvilluesit nga vlera e përfunduar e zhvillimit.

Një shkurtim prej 20% është zbatuar për ta arritur vlerën e shitjes së menjëhershme.

Një rritje/ulje e vlerës së shitjes së menjëhershme me +/- 10% do të rezultonte në një rritje/ulje të vlerës së drejtë për 208 mijë EUR (2023: 203,5 mijë EUR).

Vlera e drejtë e pronës së investimeve të bankës në njohjen fillestare dhe pastaj më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është përcaktuar në bazë të vlerësimeve të kryer në ato data nga vlerësues të pavarur, profesionalisht të kualifikuar që kanë përvojë të kohëve të fundit në vlerësimin e pronave të ngjashme në Kosovë dhe nuk janë të lidhur me Bankën.

10 PASURITË E TJERA FINANCIARE

	2024	2023
Tarifat e pranueshme të mirëmbajtjes së llogarive dhe kartelave të kreditit	2,316	2,012
Llogaritë e arkëtueshme nga institucionet financiare	5,581	6,822
Pasuritë e tjera financiare	379	328
Gjithsej pasuritë e tjera financiare (shuma bruto)	8,276	9,162
Rezervë për zhvlerësim	(1,087)	(1,076)
Gjithsej pasuritë e tjera financiare (shuma bartëse)	7,189	8,086

Të pranueshmet nga institucionet financiare lidhen me tërheqjet ose pagesat e kryera me kartela të bankave të tjera në POS ose bankomatë të bankës, këto pastrohen në një kohë të shkurtër me ofruesit e kartelave (shih shënimin 32).

Banka vlerësoi një provizion për pasuritë e tjera financiare që e kanë afatin për më shumë se 3 muaj (shih shënimin 8).

TEB SH.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare - 31 dhjetor 2024**

(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)

11 PASURITË E TJERA

	2024	2023
Pasuritë e riposeduara, neto	248	300
Shpenzimet e parapaguara	1,774	1,286
Të tjera	38	57
Provizionet për pasuritë e tjera	(97)	-
Gjithsej pasuritë e tjera	1,963	1,643

Lëvizjet në pasuritë e riposeduara gjatë vitit janë paraqitur më poshtë:

	2024	2023
Gjendja më 1 janar	301	342
Shtesat	91	184
Shlyhet deri në VNR	(144)	(225)
Më 31 dhjetor	248	301

12 PRONAT DHE PAJISJET

	Përmirësimet e hapësirave të marra me qira	Mobile, instalime dhe pajisje	Kompjuterët dhe pajisjet përcjellëse	Automjetet motorike	Gjithsej
Kosto					
Më 1 janar 2023	5,347	2,145	12,105	1,043	20,640
Shtesat	433	861	1,007	44	2,345
Heqja nga përdorimi	(27)	(694)	(651)	-	(1,372)
Më 31 dhjetor 2023	5,753	2,312	12,461	1,087	21,613
Shtesat	382	334	1,152	658	2,526
Heqja nga përdorimi	(1,994)	(1)	(48)	(242)	(2,285)
Më 31 dhjetor 2024	4,141	2,645	13,565	1,503	21,854
Zhvlerësimi i akumuluar					
Më 1 janar 2023	4,935	1,736	9,362	775	16,808
Ngarkesa për vitin	203	243	1,084	84	1,614
Heqja nga përdorimi	(27)	(687)	(654)	-	(1,368)
Më 31 dhjetor 2023	5,111	1,292	9,792	859	17,054
Ngarkesa për vitin	235	364	1,234	162	1,995
Heqja nga përdorimi	(1,988)	(0)	(44)	(242)	(2,274)
Më 31 dhjetor 2024	3,358	1,656	10,982	779	16,775
Shuma bartëse					
Më 31 dhjetor 2023	642	1,020	2,669	228	4,559
Më 31 dhjetor 2024	783	989	2,583	724	5,079

Pavarësisht se janë plotësisht të amortizuara, disa pasuri vazhdojnë të mbeten në përdorim dhe kontribuojnë në operacionet e organizatës në shumën blerëse rreth 2.8 milionë e cila vjen kryesisht nga përmirësimet në hapësirat e marra me qira, automjetet dhe alarmet.

13 PASURITË ME TË DREJTË PËRDORIMI DHE DETYRIMET E QIRASË

Banka merr me qira shumë ndërtesa për zyrë dhe hapësira për bankomatët e vet. Kontratat e qirasë zakonisht bëhen për periudha fikse prej 6 muaj deri në 10 vjet, por mund të kenë opsione për zgjatjen e qirasë për të njëjtën periudhë kohore të dhënë në marrëveshjen e qirasë. Pasuritë me të drejtë përdorimi sipas klasës së objektit përkatës analizohen si në vijim:

	Ndërtesat e zyrave	Hapësira për bankomat	Gjithsej
Shuma bartëse në datën 1 janar 2023	3,020	318	3,338
Shtesat	3,203	123	3,326
Heqja nga përdorimi	(141)	(3)	(144)
Ngarkesa e amortizimit	(1,157)	(149)	(1,306)
Shuma bartëse në datën 31 dhjetor 2023	4,925	289	5,214
Shtesat	2,302	59	2,361
Heqja nga përdorimi	(649)	(23)	(672)
Ngarkesa e amortizimit	(1,114)	(158)	(1,272)
Shuma bartëse në datën 31 dhjetor 2024	5,464	167	5,631

Detyrimi i qirasë i analizuar sipas maturitetit është si më poshtë:

Analiza e maturimit	2024	2023
Viti 1	1,188	1,410
Viti 2	1,010	1,083
Viti 3	824	922
Viti 4	480	705
Viti 5	434	235
Tutje	1,802	926
Gjithsej	5,738	5,281
Analizuar si:		
Rrjedhëse	1,188	1,410
Jo rrjedhëse	4,550	3,871
Gjithsej	5,738	5,281

Më poshtë janë paraqitur vlerat bartëse të detyrimeve të qirasë dhe lëvizjet gjatë periudhës:

	2024	2023
Gjendja më 1 janar	5,281	3,388
Shtesat	2,361	3,326
Heqja nga përdorimi	(672)	(144)
Grumbullimi i interesit	151	109
Pagesa e qirasë	(1,383)	(1,398)
Më 31 dhjetor	5,738	5,281
Llogaritë e njohura në fitim dhe humbje	2024	2023
Shpenzimi i amortizimit të pasurive me të drejtë	1,272	1,306
Shpenzimi i interesit në detyrimet e qirasë	151	109
Shpenzimi në lidhje me qiratë afatshkurta	49	17
Taksa dhe shpenzime të tjera që lidhen me qiratë	259	255
Total dalje parash për qiratë	1,731	1,687

Totali i pagesave të bëra për qiradhënësit në vitin 2024 (pa taksa) ishte 1,429 mijë (2023: 1,393 mijë).

Më 31 dhjetor 2024, Banka është zotuar 1.2 mijë EUR (2023: 1.4 mijë) për qiratë afatshkurta.

14 PASURITË E PAPREKSHME

	Softuer dhe licenca
Kosto	
Më 1 janar 2023	17,620
Shtesat	2,363
Heqja nga përdorimi	(302)
Më 31 dhjetor 2023	19,681
Shtesat	3,046
Heqja nga përdorimi	-
Më 31 dhjetor 2024	22,727
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2023	15,160
Ngarkesa për vitin	2,033
Heqja nga përdorimi	(312)
Më 31 dhjetor 2023	16,881
Ngarkesa për vitin	2,849
Heqja nga përdorimi	-
Më 31 dhjetor 2024	19,730
Shuma bartëse	
Më 31 dhjetor 2023	2,800
Më 31 dhjetor 2024	2,997

Të gjitha pasuritë e paprekshme janë pasuri të blera dhe që amortizohen gjatë jetëgjatësisë së tyre. Shtesat përbëhen kryesisht nga licencat e Microsoft, shërbimet tremujore të TI-së, licencat e softuerit Banksoft etj.

15 DEPOZITAT E KLIENTËVE

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Depozitat me kërkesë		
Individët	559,429	508,583
Entitete juridike	219,667	178,870
	779,096	687,453
Depozita me afat		
Individët	26,593	32,444
Entitete juridike	40,486	3,045
	67,079	35,489
Gjithsej depozitat e klientëve	846,175	722,942

Më 31 dhjetor 2024 depozitat me afat përfshijnë interesin e përlogaritur prej 477 mijë EUR (2023: 126 mijë EUR).

TEB SH.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare - 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)***16 DETYRIMET E TJERA FINANCIARE**

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Fondet e klientëve në tranzit	3,311	7,364
Detyrime ndaj furnitorëve	2,017	2,242
Bonuset e personelit	1,307	1,043
Bonusi i pagueshëm i kartelave të kreditit	848	767
Shërbime SMS për mobile banking	726	384
Pagesa të tjera për klientët për kartelat e kreditit	355	328
Detyrimet e tjera financiare	143	184
Gjithsej detyrimet e tjera financiare	8,707	12,312

Fondi i klientëve në tranzit përfaqëson pagesat e mbledhura nga transferet, të cilat mbetën të papaguara te përfituesit e synuar deri në fund të vitit.

Bonuset e kartelave të kreditit të pagueshme përfaqësojnë detyrimet ndaj klientëve për transaksionet e realizuara me kartela të kreditit në rrjetin e pikave të shitjes së TEB, përkatësisht për çdo blerje të bërë përmes rrjetit të tregtarëve të TEB, klientët kanë të drejtën e shpërblimeve (starpoints) të cilat mund të përdoren për blerje të mëtejshme nga klientët tek çdo tregtar ku janë instaluar pikat e shitjes së TEB.

SMS mobile banking përbën detyrimet ndaj ofruesve të shërbimeve të telekomit për dërgimin e SMS.

17 PROVIZIONET PËR DETYRIMET DHE NGARKESAT E TJERA

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
<i>Provizionet për:</i>		
HPK për zotimet e papërdorura	360	279
Rastet ligjore	51	77
HPK për garancione	5	12
Pushime të papërdorura	56	44
Provizioni tatimor	-	112
Të tjera	363	511
Gjithsej provizionet për detyrimet dhe ngarkesat e tjera	835	1,035

18 DETYRIMET E TJERA

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Tatimi i mbajtur në burim	18	31
Sigurimet shoqërore	76	80
Tatimi në të ardhurat e personelit	53	53
TVSH-ja dhe tatimet e tjera	124	210
Të tjera	505	618
Gjithsej detyrimet e tjera	776	992

Detyrimet e tjera përfshijnë shuma të pagueshme ndaj furnitorëve të ndryshëm.

19 KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar i autorizuar dhe i paguar i Bankës më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përfshin 2,400 mijë aksione të zakonshme me vlerë nominale 10 euro secili.

Aksionari	Më 31 dhjetor 2024		Më 31 dhjetor 2023	
	Përqindja e pronësisë	Shuma	Përqindja e pronësisë	Shuma
TEB Holding A.S.	100%	24,000	100%	24,000

Aksionet janë aksione të zakonshme për nga natyra dhe nuk kanë preferenca as kufizime që vlejnë për ato. Të gjitha aksionet janë paguar plotësisht. Mbajtësit e aksioneve të zakonshme kanë të drejtë të hedhin një votë për çdo aksion të zakonshëm që mbajnë. Të gjitha aksionet e TEB sh.a. i përkasin një aksionari të vetëm, përkatësisht TEB Holding A.S.

20 TË ARDHURAT NGA INTERESI

	2024	2023
Të ardhurat nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv		
Kredi dhe paradhënie për klientë në KA	45,348	38,794
Investimet në letrat me vlerë të borxhit në VDATGj	1,226	683
Detyrimet nga bankat e tjera në KA	3,269	2,583
Gjithsej të ardhurat nga interesi	49,843	42,060

21 SHPENZIMET E INTERESIT

	2024	2023
Depozitat me afat	961	563
Llogaritë e kursimit	153	46
Fondet e huazuara	38	22
Shpenzimi i interesit në detyrimet e qirasë	151	109
Gjithsej shpenzimet e interesit	1,303	740

Normat e interesit për depozita me afat dallojnë varësisht nga maturiteti i depozitave. Normat vjetore të interesit për depozitat me afat me klientët në fund të periudhës raportuese ishin si më poshtë:

- 2024 – max I/R 3.2%, min I/R 0.0%
- 2023 – max I/R 2.5%, min I/R 0.0%

22 TË ARDHURAT NGA TARIFAT DHE KOMISIONET

	2024	2023
Kartelat e kreditit	11,583	10,454
Tarifat e shërbimit të llogarisë (neto nga provizionet)	4,904	3,774
Pagesat ndërkombëtare	2,459	2,261
Shërbimet bankare me SMS	416	380
Pagesat vendore	768	624
Garancitë dhe letër kreditë	173	161
Tarifa të tjera	251	123
Gjithsej të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	20,554	17,777

Tarifat e mirëmbajtjes për kartelat e kreditit dhe llogaritë, dhe tarifat për garancionet dhe letërkreditë njihen si të ardhura kur detyrimet e përmbushjes kryhen me kalimin e kohës (grumbullohen me kalimin e kohës kur kryhen shërbimet). Bazuar në afatet e kontratës, Banka ka të drejtë të paguajë për përmbushjen e kryer në çdo fund muaj për tarifat e mirëmbajtjes së llogarive dhe në fund të vitit për tarifat e mirëmbajtjes së kartelës së kreditit.

Lidhur me komisionet për garanci dhe letërkreditë, klientët mund të zgjedhin të paguajnë komisionin në fund të muajit, në fund të tremujorit ose të paguajnë paraprakisht. Pagesat e paradhënies regjistrohen si të ardhura të pafituara dhe regjistrohen si të ardhura në bazë akruale duke iu referuar përmbylljes së shërbimit.

Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2024, të ardhurat nga tarifat dhe komisionet nga individët përbëjnë afërsisht 44% dhe të ardhurat nga tarifat dhe komisionet nga bizneset përbëjnë rreth 56% të të ardhurave totale nga tarifat dhe komisionet.

TEB SH.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare - 31 dhjetor 2024***(Të gjitha shumat janë dhënë në mijë Euro, nëse nuk është shënuar ndryshe)***23 SHPENZIME NGA TARIFAT DHE KOMISIONET**

	2024	2023
Kartelat e kreditit	6,561	5,298
Tarifat e Bankës Qendrore	591	598
Pagesat ndërkombëtare	647	597
Pagesat vendore	444	336
Tarifa të tjera	435	393
Garancitë dhe letër kreditë	1	2
Gjithsej shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	8,679	7,224

24 SHPENZIMET E TJERA OPERATIVE

	2024	2023
Depozita të Siguruara	1,476	1,329
Shpenzimet për fondin e garancisë së kredisë	571	470
Të tjera	260	74
Gjithsej shpenzimet e tjera operative	2,307	1,873

25 HUMBJET DHE PROVIZIONET E TJERA NGA ZHVLERËSIMI

	2024	2023
Rastet dhe kontestet ligjore	26	13
Provizioni për humbje operative (shënim 11)	(97)	-
Pushimi vjetor i papaguar	(12)	(10)
Zhvlerësimi për pronën e rimarrë në posedim	(144)	(225)
Provizioni për taksat	-	(112)
Provizione të tjera	(45)	(200)
Gjithsej zhvlerësimet dhe provizionet e tjera	(272)	(534)

26 KOSTOT E PERSONELIT

	2024	2023
Shpenzimet e pagave	8,816	8,002
Bonuset	1,635	1,266
Kontributet e obligueshme pensionale	492	437
Sigurimi shëndetësor	247	223
Trajnimi i stafit	192	94
Shpenzime të tjera	100	35
Gjithsej kostot e personelit	11,482	10,057

27 SHPENZIMET ADMINISTRATIVE DHE SHPENZIMET E TJERA OPERATIVE

	2024	2023
Tarifat e mirëmbajtjes së softuerit	1,581	1,399
Marketingu dhe sponsorimi	1,524	1,371
Shpenzimet e tjera	751	597
Telekomunikimet	878	761
Siguria dhe sigurimi	784	729
Tarifat për konsulencë dhe tarifat profesionale	752	606
Përfaqësimi	723	647
Riparime dhe mirëmbajtje	642	655
Shpenzimet e shërbimeve, Kartelat e kreditit	624	338
Udhëtimi	564	533
Shërbimet komunale	329	318
Furnizime të zyrës	311	291
Taksa dhe shpenzime të tjera që lidhen me qiratë	259	255
Shpenzimet e pastrimit	232	186
Tarifat ligjore, të ekzekutimit të kolateralit dhe të auditimit	547	415
Tatimet dhe licencat afariste	197	183
Shpenzimet e qirave operative për objektet	50	17
Gjithsej shpenzime administrative dhe operative	10,748	9,301

Si një përjashtim i lejuar nga kërkesat e SNRF 16, llogaritë bankare për qiratë afatshkurtra dhe qiratë e pasurive me vlerë të vogël duke njohur pagesat e qirasë si shpenzim operativ në bazë lineare.

28 TATIMI NË TË ARDHURA**a) Komponentët e shpenzimeve të tatimit mbi të ardhurat e korporatave**

	2024	2023
Shpenzimet e tatimit aktual	2,530	2,587
Shpenzimet/(kreditimi) tatimor i shtyrë	-	36
Gjithsej tatimet në të hyra	2,530	2,623

b) Barazimi ndërmjet shpenzimeve tatimore dhe fitimit ose humbjes shumëzuar me normën e aplikueshme tatimore

Në vijim është përshkruar në detaje llogaritja e normës tatimore efektive dhe barazimi i shpenzimit aktual të tatimit mbi të ardhura:

	2024	2023
Fitimi para tatimit	29,560	25,523
Ngarkesa teorike e tatimit në normën ligjore 10%	2,956	2,552
Efekti tatimor i zërave që nuk janë të zbritshme ose të vlerësueshme për qëllime tatimore:		
- Shpenzime jo të zbritshme	273	379
- Sponsorime	71	-
- Të ardhurat jo të tatueshme	(32)	(41)
- Sponsorizimi i zbritshëm	(712)	(220)
- Rregullimi i CIT	(26)	(47)
Shpenzimi i tatimit në të ardhura për vitin	2,530	2,623

Tatimi aktual mbi të ardhurat llogaritet bazuar në rregulloret e tatimit mbi të ardhurat në fuqi në Kosovë, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit. Norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është 10% (2023: 10%).

Shpenzimet e pazbritshme përbëhen nga shpenzimet e interesit dhe amortizimi për DP, shpenzimet e qirasë, argëtimi, shpenzimet e interesit etj.

Të ardhurat e patatueshme përbëhen nga të ardhurat nga interesi nga letrat me vlerë

28 TATIMI NË TË ARDHURA (VAZHDIM)

c) Lëvizja në gjendjet tatimore të shtyra

Dallimet ndërmjet pasqyrave financiare sipas SNRF-ve dhe rregulloreve tatimore të Kosovës shkaktojnë disa diferenca të përkohshme ndërmjet shumës bartëse të kredive dhe paradhënieve për klientë për qëllime të raportimit sipas SNRF-ve dhe për qëllime të tatimit. Efekti tatimor i këtyre diferencave të përkohshme llogaritet në normën e miratuar prej 10% (2023: 10%).

Efekti tatimor i lëvizjeve në dallimet e përkohshme në vitin 2024 është dhënë më poshtë në detaje.

	1-jan-2024	Ngarkuar/ (kredituar) në pasqyrën e fitimit ose humbjes	Ngarkuar / (kredituar) direkt në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	31-dhj-2024
Efekti tatimor i dallimeve të përkohshme				
Detyrimet e qirasë	461	112	-	573
Vlerësimi i drejtë i pronave të investimeve	(84)	(5)	-	(89)
Pasuritë me të drejtë përdorimi	(456)	(107)	-	(563)
Vlerësimi i drejtë i investimeve në letrat me vlerë të borxhit	27	-	(64)	(37)
Neto pasuri /(detyrim) i tatimit të shtyrë	(52)	-	(64)	(116)
Pasuritë e njohura të tatimit të shtyrë	33	-	(64)	(31)
Detyrimi i njohur i tatimit të shtyrë	(85)	-	-	(85)
Neto pasuri /(detyrim) i tatimit të shtyrë	(52)	-	(64)	(116)

Efekti tatimor i lëvizjeve në dallimet e përkohshme në vitin 2023 është dhënë më poshtë në detaje.

	1-jan-2023	Ngarkuar/ (kredituar) në pasqyrën e fitimit ose humbjes	Ngarkuar / (kredituar) direkt në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	31-dhje-2023
Efekti tatimor i dallimeve të përkohshme				
Detyrimet e qirasë	338	123	-	461
Vlerësimi i drejtë i pronave të investimeve	(72)	(12)	-	(84)
Pasuritë me të drejtë përdorimi	(334)	(122)	-	(456)
Vlerësimi i drejtë i investimeve në letrat me vlerë të borxhit	95	-	(67)	28
Neto pasuri /(detyrim) i tatimit të shtyrë	27	(11)	(67)	(51)
Pasuritë e njohura të tatimit të shtyrë	101	-	(67)	34
Detyrimi i njohur i tatimit të shtyrë	(74)	(11)	-	(85)
Neto pasuri /(detyrim) i tatimit të shtyrë	27	(11)	(67)	(51)

29 SHPALOSJET E PALËVE TË NDËRLIDHURA

Palët përgjithësisht konsiderohen të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontroll të përbashkët ose njëra palë ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operationale. Kur merret parasysh çdo marrëdhënie e mundshme ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet substancës së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore. Banka kontrollohet nga TEB Holding A.S, e inkuorporuar në Turqi (banka amë e drejtpërdrejtë), e cila ka në pronësi 100% të aksioneve të zakonshme më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 (shih Shënimi 1). Tabela në vijim përmbledh transaksionet e palëve të ndërlidhura dhe bilancet më 31 dhjetor 2024 dhe shpenzimet e ndërlidhura për vitin e përfunduar atëherë. Kreditë dhe paradhëniet për bankat e palëve të lidhura janë të gjitha llogari rrjedhëse nostro që nuk kanë normë interesi. Kreditë dhe paradhëniet për klientët dhe depozitat e klientëve janë kredi dhe depozita për palët e ndërlidhura. Shpenzimet nga komisionet përbëhen nga komisioni ndërkombëtar i korrespondencës dhe tarifat dhe shpenzimet operative janë shpenzime konsulence me palët e ndërlidhura. Pasuritë jo të prekshme janë tarifa nga Grupi për zhvillimet në sistemin e Bankës që plotësojnë përkufizimin e pasurive të paprekshme. Garancitë në fund të vitit përbëjnë garanci të lëshuara nga Banka me konfirmimin e bankave të grupit. Te gjitha transaksionet kryhen në përputhje me parimet sipas tregut.

Më 31 dhjetor 2024, bilancet e papaguara me palët e ndërlidhura ishin si më poshtë:

	Kompania përfundimtare amë	Kompania e menjëhershme amë	Entitetet nën kontroll të përbashkët	Personeli kryesor i menaxhimit
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	128	-	581	-
Kredi dhe paradhënie për klientë	-	-	-	286
Pasuritë e paprekshme	-	-	1,000	-
Depozitat e klientëve	-	-	-	63
Detyrimet e tjera financiare	172	41	282	-

Zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve me palët e ndërlidhura për vitin 2024 ishin si më poshtë:

	Kompania përfundimtare amë	Kompania e menjëhershme amë	Entitetet nën kontroll të përbashkët
Të ardhurat nga interesi	3	-	19
Shpenzime nga komisionet	22	-	288
Shpenzime operative	-	332	16

Më 31 dhjetor 2024, të drejtat dhe detyrimet e tjera me palët e ndërlidhura ishin si më poshtë:

	Kompania përfundimtare amë	Kompania e menjëhershme amë	Entitetet nën kontroll të përbashkët	Personeli kryesor i menaxhimit
Garancitë e lëshuara në fund të vitit	200	-	4,327	53

29 SHPALOSJET E PALËVE TË NDËRLIDHURA (VAZHDIM)

Më 31 dhjetor 2023, bilancet e papaguara me palët e ndërlidhura ishin si më poshtë:

	Kompania përfundimtare amë	Kompania e menjëhershme amë	Entitetet nën kontroll të përbashkët	Personeli kryesor i menaxhimit
Kreditë dhe paradhëniet për banka	59	-	535	-
Kredi dhe paradhënie për klientë	-	-	-	156
Pasuritë e paprekshme	-	-	-	-
Depozitat e klientëve	-	-	-	302
Detyrimet e tjera financiare	115	25	213	-

Zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve me palët e ndërlidhura për vitin 2023 ishin si më poshtë:

	Kompania përfundimtare amë	Kompania e menjëhershme amë	Entitetet nën kontroll të përbashkët
Të ardhurat nga interesi	-	-	24
Shpenzime nga komisionet	3	-	109
Shpenzime operative	-	274	-

Më 31 dhjetor 2023, të drejtat dhe detyrimet e tjera me palët e ndërlidhura ishin si më poshtë:

	Kompania përfundimtare amë	Kompania e menjëhershme amë	Entitetet nën kontroll të përbashkët	Personeli kryesor i menaxhimit
Garancitë e lëshuara në fund të vitit	550	-	4,412	52

Kompensimi kryesor i menaxhimit paraqitet më poshtë:

	2024	2023
Paga	471	442
Bonuset	259	157
Gjithsej	730	599

30 ZOTIMET DHE RASTET E PAPARASHIKUARA**Garancitë dhe letërkreditë**

Zotimet e lidhura me kreditë. Qëllimi primar i këtyre instrumenteve është të sigurojë që fondet janë në dispozicion të një klienti sipas nevojës. Garancitë dhe letërkreditë, të cilat paraqesin siguri të pakthyeshme se Banka do të bëjë pagesat në rast se një klient nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj palës së tretë, kanë të njëjtin rrezik kreditor si kreditë.

Zotimet e ndërlidhura me kreditë (vazhdim). Letrat kreditore dokumentare dhe komerciale, të cilat janë ndërmarrje të shkruara nga Banka në emër të një klienti që autorizon një palë të tretë për të nxjerrë drafte në Bankë deri në një shumë të përcaktuar sipas afateve dhe kushteve specifike, janë të kolateralizuara nga dërgesat themelore të mallrave për të cilat ato lidhen ose depozita në para dhe, për rrjedhojë, kanë më pak rrezik sesa një huamarrje direkte.

Angazhimet për ta zgjeruar kredinë paraqesin pjesë të papërdorura të autorizimeve për të zgjeruar kredi në formën e huamarrjes, garancive ose letërkredive. Sa i përket rrezikut kreditor për zotimet për ta zgjatur kredinë, Banka mund të ekspozohet ndaj humbjes në një shumë të barabartë me totalin e zotimeve të papërdorura, nëse shumat e papërdorura do të tërhiqen. Megjithatë, shuma e mundshme e humbjes është më pak se totali i zotimeve të papërdorura sepse shumica e zotimeve për të dhënë kredi varen nga ajo nëse klientët mbajnë standardet specifike për kredi.

Banka monitoron afatin e maturimit të zotimeve për kredi, sepse zotimet afatgjata në përgjithësi kanë një shkallë më të madhe të rrezikut kreditor se zotimet më afatshkurtra.

Shuma e grumbulluar e papaguar e garancive dhe letër kredive të lëshuara nga Banka, është si vijon:

	2024	2023
Garancitë financiare	10,115	9,270
Letër kreditë	1,655	2,469
Garancitë e tjera	51	78
Gjithsej	11,821	11,817
Zotimet e papërdorura për kreditë revolvuese	124,552	103,950
Gjithsej zotimet e lidhura me kreditë	136,373	115,767
HPK për garanci	(5)	(12)
HPK për kreditë revolvuese	(360)	(279)
Gjithsej zotimet e lidhura me kreditë, neto nga HPK	136,008	115,476

30 ZOTIMET DHE RASTET E PAPARASHIKUARA (VAZHDIM)**Garancitë dhe letër kreditë (vazhdim)**

Zotimet sipas cilësisë së kredisë bazuar në klasifikimet e rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2024 janë si më poshtë.

	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësi së për SICR)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e zhvlerësua ra)	Gjithsej
Garancitë financiare	10,037	78	-	10,115
Letër kreditë	1,655	-	-	1,655
Garancitë e tjera	38	13	-	51
Gjithsej garancitë dhe letër kreditë	11,730	91	-	11,821
Zotimet e kredisë ende të padisbursuara	120,849	3,703	-	124,552
Gjithsej zotimet e lidhura me kreditë	132,579	3,794	-	136,373
Minus: Provizionit për garancitë dhe letërkreditë	(3)	(2)	-	(5)
Minus: Provizionit i zotimeve të kredive	(204)	(156)	-	(360)
Gjithsej zotimet	132,372	3,636	-	136,008

Zotimet sipas cilësisë së kredisë bazuar në klasifikimet e rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë.

	Faza 1 (HPK 12 mujore)	Faza 2 (HPK e tërë jetëgjatësisë për SICR)	Faza 3 (HPK e tërë jetëgjatësisë për kreditë e zhvlerësuar)	Gjithsej
Garancitë financiare	9,270	-	-	9,270
Letër kreditë	2,469	-	-	2,469
Garancitë e tjera	56	22	-	78
Gjithsej garancitë dhe letër kreditë	11,795	22	-	11,817
Zotimet e kredisë ende të padisbursuara	101,199	2,751	-	103,950
Gjithsej zotimet e lidhura me kreditë	112,994	2,773	-	115,767
Minus: Provizionit për garancitë dhe letërkreditë	(9)	(3)	-	(12)
Minus: Provizionit i zotimeve të kredive	(162)	(117)	-	(279)
Gjithsej zotimet	112,823	2,653	-	115,476

30 ZOTIMET DHE RASTET E PAPARASHIKUARA (VAZHDIM)

Banka llogarit provizionet HPK dhe HPKJ për garancitë dhe letërkreditë duke ndjekur të njëjtat hapa si për ekspozimet në bilanc, të cilat ndryshojnë vetëm në lidhje me llogaritjen EnM. Referojuni shpalosjes së rrezikut kreditor në shënimin 32.

Rastet ligjore

Në rrjedhën normale të biznesit Banka përballlet me kërkesa ligjore. Menaxhmenti i Bankës beson se mundësia e një rrjedhjeje të përfitimeve ekonomike në lidhje me pretendimet ligjore të pazgjidhura më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është e largët, me përjashtim të provizioneve të ngarkuara siç tregohet në shënimin 17 – Provizionet për detyrime dhe Ngarkesa.

31 MENAXHIMI I KAPITALIT

Objektivat e Bankës me rastin e menaxhimit të kapitalit janë:

- të jetë në përputhje me kërkesat për kapital të vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK);
- të ruajë aftësinë e Bankës për ta vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe për të vazhduar të ofrojë kthime për aksionarin; dhe
- të mbajë një bazë të fortë kapitale për ta mbështetur zhvillimin e biznesit të saj.

Adekuatshmëria e kapitalit dhe shfrytëzimi i kapitalit rregullator monitorohen rregullisht nga menaxhmenti i Bankës që shfrytëzon teknika në bazë të udhëzimeve të BQK-së. Informatat e nevojshme i ofrohen BQK-së në baza mujore.

Banka llogarit kapitalin për rrezikun kreditor për zërat e bilancit dhe jashtë bilancit, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional.

Rregullorja e BQK-së për Mjaftueshmërinë e Kapitalit të Bankave kërkon që bankat të mbajnë një kapital rregullator minimal prej 7,000 mijë euro, të mbajnë një raport minimal të kapitalit të klasit të parë ndaj pasurive të ponderuara sipas rrezikut prej 9%, totali minimal i kapitalit rregullator ndaj pasurive të ponderuara sipas rrezikut prej 12%, dhe një raport minimal të levës prej 3%.

Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, Banka është në përputhje me të gjithë treguesit rregullativ: Kapitali i klasit I që nga 31 dhjetori 2024 është 14.23% (2023: 13.89%), totali i kapitalit rregullator është 15.05% (2023: 14.74%), dhe raporti i levës është 10.48% (2023: 10.08%).

Banka ishte në përputhje me kërkesat rregullative në datat e raportimit, më 31 dhjetor 2024 dhe 2023.

31 MENAXHIMI I KAPITALIT (VAZHDIM)**Treguesit e kapitalit minimal të bazuar në rrezik**

Nivelet e kapitalit, pasuritë e peshuara me rrezik dhe raportet e adekuatshmërisë së kapitalit sipas rregulloreve të BQK-së më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë si më poshtë:

	2024	2023
Kapital i klasit 1		
Kapitali aksionar	24,000	24,000
Fitimet e mbajtura sipas raportimit të Bankës Qendrore të Kosovës	89,393	70,993
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të akumuluar (dhe rezerva të tjera)	(1,877)	(2,451)
Minus: Pasuritë e paprekshme	(2,997)	(2,800)
Kreditë për persona të ndërlidhur me bankën	(1,148)	(954)
Gjithsej kapitali i kualifikuar për Klasin 1	107,371	88,788
Provizionet për humbjet nga kreditë (kufizuar në 1.25% të RWA-së)	6,221	5,468
Gjithsej kapitali i kualifikuar për Klasin 2	6,221	5,468
Gjithsej kapitali rregullator	113,592	94,256
Pasuritë e ponderuara sipas rrezikut:		
Në bilanc të gjendjes	668,145	569,113
Jashtë bilancit të gjendjes	11,816	11,804
Pasuritë e rrezikut për rrezikun operacional	57,310	49,585
Rreziku i tregut	17,296	8,779
Gjithsej pasuritë e ponderuara sipas rrezikut	754,567	639,281
Raporti i kapitalit i klasit të parë ndaj pasurisë së ponderuar sipas rrezikut	14.23%	13.89%
Raporti i totalit të kapitalit rregullator ndaj pasurive të ponderuara sipas rrezikut	15.05%	14.74%
Total raporti i levës (raportimi rregullativ)	10.48%	10.08%

Në përputhje me rregulloren e BQK-së për rrezikun kreditor, duke filluar nga 1 janari 2020 “SNRF 9 - Instrumentet Financiarë” është i zbatueshëm edhe për pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare.

32 MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Funksioni i menaxhimit të rrezikut brenda Bankës kryhet në lidhje me rreziqet financiare dhe rreziqet operationale. Rreziku financiar përfshin rrezikun kreditor, rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e valutës, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqet e tjera të çmimeve) dhe rrezikun e likuiditetit. Funksioni primar i menaxhimit të rrezikut është vendosja e limiteve të rrezikut dhe sigurimi që çdo ekspozim ndaj rrezikut të qëndrojë brenda këtyre kufijve të përcaktuara nga organi rregullator dhe nga bordi i drejtorëve të bankës. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe politikave dhe procedurave në mënyrë që të minimizohen rreziqet operationale dhe ligjore.

Rreziku i tregut

Aktivitetet e Bankës janë deri diku të ekspozuara ndaj humbjeve të mundshme si rezultat i ekspozimit të instrumenteve të saj financiarë në rrezikun e normës së interesit ose të rrezikut të kursit të këmbimit që rezultojnë nga luhatjet në tregjet financiare. Shumica e transaksioneve të Bankës janë në valutën vendase dhe shumica dhe ekspozimi ndaj rrezikut të këmbimit valutor është i kufizuar.

32 MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**Rreziku i valutave të huaja**

Politika për menaxhimin e rrezikut nga valutat e huaja në TEB Sh.a. përcakton metodat për menaxhimin e rrezikut nga valutat e huaja në Bankë. Banka menaxhon rrezikun e këmbimit valutor nëpërmjet menaxhimit të strukturës valutore të pasurive dhe detyrimeve të saj. Rreziku i këmbimit valutor menaxhohet dhe udhëhiqet sipas politikave të Grupit. TEB Sh.A. vazhdimisht monitoron lëvizjet në normën e këmbimit dhe në tregje të valutave të huaja dhe përcakton pozitën e vet valutore në baza ditore.

Për çdo përjashtim nga kjo politikë duhet të merret miratimi i Bordit të Drejtorëve të TEB Sh.A. Banka nuk mban pozitën e hapur të valutës për qëllime spekulative. Prapëseprapë derivativat e këmbimit mund të shfrytëzohen për qëllime të mbrojtjes për mbylljen e pozitave të caktuara, me ç'rast ato monitorohen për të afërmi si në nivel lokal ashtu edhe grupor. Banka ndërmerr transaksione në EUR dhe në valuta të huaja.

Banka nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje të këmbimit të ardhshëm të derivativëve dhe nuk ka asnjë derivativ të përfshirë më 31 dhjetor 2024 dhe 2023.

Meqenëse Banka i paraqet pasqyrat e saja financiare në Euro, pasqyrat financiare të bankës ndikohen nga lëvizjet në kurset e këmbimit midis euros dhe valutave të tjera.

Ekspozimet transaksionale të Bankës mundësojnë fitime dhe humbje nga valutat e huaja që njihen në fitim dhe humbje. Këto ekspozime përfshijnë pasuritë monetare dhe detyrimet monetare të bankës që nuk shprehen në valutën funksionale të Bankës.

Analiza e ndjeshmërisë ndaj valutës së huaj

Banka kryesisht i ekspozohet dollarit amerikan (USD) dhe frangut zviceran (CHF). Tabela e mëposhtme jep në detaje ndjeshmërinë e Bankës ndaj rritjes dhe rënies përkatëse në vlerën e Euros kundrejt valutave të huaja. Përqindja e përdorur është analiza e normës së ndjeshmërisë përfaqëson vlerësimin e menaxhmentit të ndryshimit të mundshëm të arsyeshëm në normat e këmbimit të valutës së huaj.

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetarë të hapur në valutë të huaj dhe korrigjon përkthimin e tyre në fund të periudhës për ndryshimin përkatës në normat valutore. Banka ka aplikuar një rritje ose ulje prej 10% në normat aktuale të këmbimit valutor. Numri pozitiv më poshtë tregon rritje në fitim dhe ekuitet tjetër ku Euro forcohet me përqindjet përkatëse kundrejt valutës përkatëse.

Tabela në vijim përmbledh pozitës valutore të bankës më 31 dhjetor 2024:

	EURO	USD	CHF	Të tjera	Gjithsej
Pasuritë financiare					
Paraja e gatshme dhe llogaritë rrjedhëse në banka	136,378	1,148	1,606	573	139,705
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	78,402	2,311	4,706	880	86,299
Neto kreditë dhe paradhëniet e dhëna klientëve	719,007	-	-	-	719,007
<i>Kreditë për individë</i>	360,969	-	-	-	360,969
<i>Kreditë për persona juridikë</i>	369,067	-	-	-	369,067
<i>Kreditë e zhvlerësuar</i>	(11,029)	-	-	-	(11,029)
Investimet në letrat me vlerë të borxhit	14,338	16,829	-	-	31,167
Pasuritë e tjera financiare	7,179	8	2	-	7,189
Gjithsej pasuritë	955,304	20,296	6,314	1,453	983,367
Detyrimet financiare					
Depozitat e klientëve	818,784	19,655	6,284	1,452	846,175
Detyrimet e qirasë	5,738	-	-	-	5,738
Detyrimet e tjera financiare	8,706	1	-	-	8,707
Gjithsej detyrimet	833,228	19,656	6,284	1,452	860,620
Pozicioni valutor neto më 31 dhjetor 2024	122,076	640	30	1	122,747

32 MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Tabela në vijim përmbledh pozicionin valutor të bankës më 31 dhjetor 2023:

	EURO	USD	CHF	Të tjera	Gjithsej
Pasuritë financiare					
Paraja e gatshme dhe llogaritë rrjedhëse në banka	110,213	572	1,031	409	112,225
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	77,139	18,995	4,860	1,566	102,560
Neto kreditë dhe paradhëniet e dhëna klientëve	598,079	-	-	-	598,079
<i>Kreditë për individë</i>	314,223	-	-	-	314,223
<i>Kreditë për persona juridikë</i>	294,297	-	-	-	294,297
<i>Kreditë e zhvlerësuara</i>	(10,441)	-	-	-	(10,441)
Investimet në letrat me vlerë të borxhit	21,535	-	-	-	21,535
Pasuritë e tjera financiare	8,086	-	0	-	8,086
Gjithsej pasuritë	815,052	19,567	5,891	1,975	842,485
Detyrimet financiare					
Depozitat e klientëve	695,589	19,500	5,887	1,966	722,942
Detyrimi i qirasë	5,281	-	-	-	5,281
Detyrimet e tjera financiare	12,310	0	2	0	12,312
Gjithsej detyrimet	713,180	19,500	5,889	1,966	740,535
Pozicioni valutor neto më 31 dhjetor 2023	101,872	67	2	9	101,950

Analiza e ndjeshmërisë ndaj valutës:

	2024		2023	
	Efekti në fitimin para tatimit	Efekti në fitimin para tatimit	Efekti në fitimin para tatimit	Efekti në fitimin para tatimit
	10+	10-	10+	10-
USD	90.39	(41.14)	14.4	(0.4)
CHF	(0.96)	5.05	0.1	(0.7)

Bazuar në politikat e Bankës, pozitat valutore të hapura individuale nuk duhet të jenë mbi 5% të kapitalit të klasit 1 dhe ekspozimi total në të gjitha valutat nuk duhet të jenë mbi 10% të kapitalit të klasit 1 në asnjë moment të caktuar kohor, ndërkohë që sipas kërkesave të BQK-së, pozita valutore e hapur për çdo valutë nuk duhet të kalojë 15% të kapitalit të klasit 1 dhe ekspozimi total nuk duhet të kalojë 30% të kapitalit të klasit 1. Më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 Banka ka qenë në pajtueshmëri me këta tregues.

Kurset e këmbimit të aplikuara për valutat kryesore ndaj euros ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Dollari amerikan (USD)	1.0389	1.1050
Franga zvicerane (CHF)	0.9412	0.9260
Funta britanike (GBP)	0.8292	0.8691

32 MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**Rreziku i normës së interesit**

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e instrumentit financiar të luhetet për shkak të ndryshimeve të normave të interesit në treg dhe që maturimet e pasurive dhe detyrimeve me interes të mos përputhen. Koha gjatë së cilës norma e interesit mbetet fikse përcakton shkallën e ekspozimit ndaj këtij rreziku. Rreziku buron nga pasuritë dhe detyrimet financiare të ndjeshme ndaj normës së interesit (NI). Rreziku i normës së interesit (RNI) mund të lindë në rritjen e normës së interesit të detyrimeve dhe si rezultat mund të shkaktojë kosto më të lartë të marrjes së fondeve, ndërsa në anën e pasurive, nëse ulet norma e interesit, kjo mund të ndikojë në fitimet e bankës. Në të dy skenarët, analiza e hendekut të kohëzgjatjes është vendimtare për të identifikuar ndjeshmërinë e NI. Analiza e hendekut të kohëzgjatjes është një metodologji e thjeshtë e RNI që ofron një mënyrë të lehtë për të identifikuar boshllëqet e rivlerësimit për monitorimin e rrezikut të normës së interesit që rrjedh nga mospërputhja e maturitetit në bilanc. Analiza e hendekut ndihmon në identifikimin e mospërputhjeve të maturitetit dhe rivendosjes së çmimit ndërmjet pasurive, detyrimeve dhe instrumenteve jashtë bilancit të gjendjes. Skemat e boshllëqeve veçojnë PNN-të, DNN-të dhe instrumentet jashtë bilancit sipas karakteristikave të tyre të rishmimit. Për qëllime likuiditeti, përdoret data e maturimit, ndërsa për hendeqet e normave të interesit, data e rivendosjes së çmimit është e rëndësishme.

Për më tepër, departamenti i menaxhimit të rrezikut monitoron ekspozimin ndaj RNI duke përdorur metodologjinë e analizës së hendekut të normës së interesit e cila bazohet në supozimet e brendshme me kufijtë e përafërt të caktuar për maturime të ndryshme.

Qëllimi i politikës që miratohet nga Bordi Drejtues (BD), është menaxhimi i ekspozimit ndaj RNI dhe kufizimi i humbjeve të mundshme, si rezultat i modifikimit të niveleve të normave të interesit në treg dhe efektit të këtyre ndryshimeve në rezultatet e biznesit dhe vlerën e tregut të kapitalit të Bankës.

Politikat e RNI janë aprovuar nga BiD dhe rishikohen në baza të rregullta, ndërsa menaxhmenti i lartë është përgjegjës për të siguruar që politikat dhe procedurat e miratuara nga BiD të ekzekutohen në mënyrë të përshtatshme. Politika e tillë e menaxhimit të rrezikut e miratuar nga BD, përcakton metodën e identifikimit, matjes, monitorimit dhe kontrollit të rrezikut në rast të modifikimit të normës së interesit.

Të gjitha instrumentet dhe pozitat të cilat janë të ndjeshme ndaj rrezikut të normës së interesit klasifikohen në librin bankar. Pozitat vrojtohen në pajtim me këto segmente:

- Pozitat e ndjeshme në normë të interesit në valutën EUR.
- Pozitat e ndjeshme në normë të interesit në valutat e tjera (vlera totale dhe sipas secilës valutë).

Menaxhmenti beson se Banka nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit për instrumentet e saj financiare.

Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit

